

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVII i botimit, nr. 197, Mars 2020
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355674001940, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Suela Ndoja, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

7 e 8 MARSINI NË TIRANË

2 (VEPRIMTARI E SHOQATËS ATDHETARE DUKAGJINI - DEGA TIRANË)

Me datën 8 mars 2020, në mjediset e Muzeut Kombëtar Tiranë, Shoqata Atdhetare Dukagjini, Dega Tiranë, organizoi një veprimtari në kuadrin e festave të 7 e 8 marsit. Morën pjesë anëtarë të shoqatës e të ftuar. Ndryshe nga herët e tjera ishte një pjesëmarrje më e madhe e zonjave dhe zonjushave që kishin vlerësuar më së miri këtë veprimtari. Nderuan me pjesëmarrjen e tyre, kryetari Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", z. Ndue Sanaj, zv kryetari z. Gjergj Liqejza dhe anëtarët e kryesisë znj. Roza Pjetri dhe z. Aleks Dushi. Mirëseardhjen dhe fjalën e rastit për ditën e 7 Marsit e mbajti kryetari i degës Tiranës z. Zef Bari. Ai u ndal jo vetëm tek aspektet historike të kësaj date, tek aspektet e zhvillimit historik të arsimit në Dukagjin, por së shumti ai u ndal tek rëndësia e veçantë që merr, arsimit cilësor në këtë periudhë. Jo vetëm mësuesit e shkolla që duhet të rrisë përgjegjësinë, por është me rëndësi jetike që familja, shoqëria civile të kontribuojnë fuqishëm që fëmijët tanë, jo vetëm të shkollohen, por të kenë një nivel të lartë cilësor. Fëmijët tanë janë ata që do përballën me sfidat e integritimit në Evropë dhe jo vetëm.



LUFTA KUNDËR KRIMINALITETIT KËRKON MOBILIZIM NGA TË GJITHË E JO VETËM NGA POLICIA

Në ditën e fundit të muajit shkurt, Shoqata Atdhetare "Dukagjini" në bashkëpunim me drejtorinë e policisë në Shkodër, bashkinë Shkodër dhe Prefekturën e Qarkut Shkodër, organizuan një tryezë të rrumbullaktë në lidhje me punën që duhet bërë për eliminimin e drogës dhe veprimtarinë kriminale në krahinën e Dukagjinit, qëllimi i të cilës ishte: "Të bëhen përpjekje për të parandaluar mbjelljen e përdorimin e lëndëve narkotike në krahinën e Dukagjinit, në mënyrë që të jete e mundur nga kjo e keqe e madhe".

3

LUFTA KUNDËR PËRDORIMIT TË LËNDËVE NARKOTIKE, EFEKTET SHOQËORE DHE MJEKËSORE...

Sot lufta kundër gjithë llojeve të drogave qoftë legale ose të paligjshme është një problem madhor kudo në botë por këtë 20 vitet e fundit dhe për vendin tonë; jo vetëm për kultivimin e marjuanes, kanabisit, përdorim i alkooleve, duhanit por ka filluar përdorimi i formave të ndryshme të drogave në kombinim si: alkoool + hashash, narkotike të ndryshme që nga morfina, heroina, valium e gjinitë e tij. Pra është një problem madhor jo vetëm i shëndetit publik, por edhe për gjithë shoqërinë.

7

RRITJA EKONOMIKE SOCIALE E KULTURORE, MUNDËSIA KRYESORE PËR ULJEN DHE LARGIMI NGA KRIMINALITETIT

Në çdo kohë ka pasur dhe ka krime të formave dhe përmasave të ndryshme, të cilat kanë kurbat e ulje ngritjes së tyre, në përhapje, në llojshmëri, edhe me pasoja negative. Me keqardhje e them se vitet e fundit kurba e kriminalitetit në krahinën e Dukagjinit ka ngritje, gjë që ka çuar edhe në konflikte, ngatresa, të cilat kanë qenë shkak edhe për kanflike fatale, siç janë krimi kundër personit, prodhimi dhe përhapja e bimëve narkotike, armëmbajtja pa leje, të cilat e bëjnë jetën e komunitetit të vështirë, humbë besimi për punë, humbë perspektiva, krijon një amulli që nuk sjellë asgjë pozitive, por vetëm negativitet, depresion, neuroza, të cilat çojnë veprime emocionale e impulsive. Dëgjojmë në media të ndryshme se Dukagjini është prodhues i madh, mbase kampion thuhet ndonjë herë, i prodhimit të drogës. Nuk them se nuk ka prodhim të kësaj bime dhe sigurisht bëhen përpjekje për ta futur në treg, sepse për atë qëllim prodhohet por që të jenë kampion nuk e mendoj një gjë të tilla. Nuk kam dhe nuk kam parë asnjë statistikë zyrtare, dhe krahasime me zona apo krahina të tjera, ...

8



7 e 8 MARSINI NË TIRANË

(VEPRIMTARI E SHOQATËS ATDHETARE DUKAGJINI - DEGA TIRANË)

Me datën 8 mars 2020, në mjesditet e Muzeut Kombëtar Tiranë, Shoqata Atdhetare Dukagjini, Dega Tiranë, organizoi një veprimtari në kuadrin e festave të 7 e 8 marsit. Morën pjesë anëtare të shoqatës e të ftuar. Ndryshe nga herët e tjera ishte një pjesëmarrje më e madhe e zonjave dhe zonjushave që kishin vlerësuar më së miri këtë veprimtari. Nderuan me pjesëmarrjen e tyre, kryetari Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", z. Ndue Sanaj, zv kryetari z. Gjergj Liqezja dhe anëtarët e kryesisë znj. Roza Pjetri dhe z. Aleks Dushi. Mirëseardhjen dhe fjalën e rastit për ditën e 7 Marsit e mbajti kryetari i degës Tiranës z. Zef Bari. Ai u ndal jo vetëm tek aspektet historike të kësaj date, tek aspektet e zhvillimit historik të arsimit në Dukagjin, por së shumti ai u ndal tek rëndësia e veçantë që merr, arsimit cilësor në këtë periudhë. Jo vetëm mësuesit e shkolla që duhet të rrisë përgjegjësinë, por është me rëndësi jetike që familja, shoqëria civile të kontribuojnë fuqishëm që fëmijët tanë, jo vetëm të shkollohen, por të kenë një nivel të lartë cilësor. Fëmijët tanë janë ata që do përballen me sfidat e integritimit në Evropë dhe jo vetëm.

Znj. Tringa Rapi, anëtare e kryesisë e degës, foli për ditën e 8 Marsit. Ajo u ndal jo vetëm tek aspektet historike të kësaj date që nga krenimi se pari deri kur kjo tashmë është një datë rëndësishme në kalendarin e OKB. Gruaja shqiptare në tërësi dhe në veçanti nënat dhe motrat tona dukagjinase janë përfshirë në veprimtari dhe kontribuar që ato të kenë sa më shumë të drejta të merituar. Ajo renditi shembuj të suksesit në botë dhe në vendit tonë, ku gratë kanë dhënë kontribute të mëdha me vlera historike. Gratë tashmë duhet të përpqen në vijimësi, të jenë aktive në shoqëri, që në të gjitha drejtimet të marrin atë rol të rëndësishëm pa të cilin asnjë shoqëri nuk mund të emancipohet dhe të ecë përpara pa gra të mirë vlerësuar. Në fund të fundit një shoqëri, shtet apo grup i caktuar vlerësohet sa i emancipuar, sa demokratik dhe social është me shkallën që ai ka të vlerësuar dhe të emancipuar gratë. Ne, 8 Marsin duhet ta konsiderojmë si ditë feste në të gjitha rastet kur fitojmë një kauzë dhe një vlerë të mohuar, por gjithnjë duhet ta konsiderojmë dhe si një ditë proteste për të arritur një objektiv të caktuar që shërben në tërësi shoqërisë dhe zhvillimit të grave dhe vajzave. Ne duhet të jemi të vëmendshme se sot në një shoqëri të hapur me demokratike ka disa forma të kamufluara, që cenojnë dinjitetin dhe vlerat e grave. Është pagesa e punës e diferencuar më e ulët e grave, hapësirat më të paketa për punësim, përfaqësimi jo i mjaftueshëm politik, dhuna në familje plagë, me të cilat po ndeshen gratë dhe shoqëria jonë. Të punojmë pa reshtur, ti zgjidhim ne gratë por të mbështetura nga gjithë aktorët shtetëror dhe shoqëror. Ashtu që në themel të çdo familje të shëndoshë është nëna, ashtu dhe (nuk mund të ndodhë ndryshe) një shoqëri e zhvilluar

në themel ka kontributin e pa zëvendësueshëm të grave dhe vajzave.

Kryetari shoqatës atdhetare Dukagjini, z. Ndue Sanaj duke falënderuar për organizimin e kësaj veprimtarie në Tiranë, u ndal: "Kryesia e Shoqatës, jo vetëm që e ka nderin t'iu takojë dhe të komunikojë me ju, në veçanti për punën e madhe e fisnike që bëni për rritjen e fëmijëve me normat qytetare, që ata të jënë të aftë për të dalë në jete, si dhe për rolin e mësuesit e mësueset në dhënien e diturisë e edukimi-

dardeve evropiane".

Për të realizuar këtë mision të shoqatës, roli i nënës dhe i mësuesit është i padiskutueshëm. Kryesia e Shoqatës do të bëjë përpjekjet e saj, që nëpërmjet medias të shkruar e asaj televizive, nëpërmjet veprimtarive të ndryshme, nëpërmjet takimeve e vizitave në mjediset edukative, por rolin tuaj nuk mund ta zëvendësojë. Prandaj, në të ardhmen do të bëjë përpjekje për t'iu takuar më shpesh, për të tërhequr mendime, për të stimuluar nxënësit më të



min e nxënësve e nxënësve, për edukimi e fëmijëve, që ata apo ato të emancipohen me normat qytetare.

Konferenca e VI të Shoqatës, vendosi të ndryshojë misionin e saj, dhe Shoqata në të ardhmen të punojë me Misionin, "Puna dhe përpjekjet që duhen bërë, krahas vijimit të njohjes së mëtejshme e promovimit të vlerave të zonës së Dukagjinit, për emancipimin shoqëror të dukagjinaseve kudo janë, me objektivin që si qytetar të mirë e në bashkëpunim me njeri - tjetrin, të ecim përpara drejte stan-

mirë, për të përgatitë ore letrare me nxënësit krijues, për hapur ekspozita pikturë e veprimtari të tjera me talentet përkatëse.

Për këtë qëllim Këshilli i Shoqatës miratoi ngritjen e seksionit për marrëdhëniet me shkollat, dhe seksionin e gruas. Kam besimin, se më mirë do të ecim në të ardhmen për një bashkëpunim sa më efektiv, në shërbim të realizimit të misionit tuaj, për realizimin e misionit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini".

Të emancipohem, duhet kuptuar, që të çlirohemi nga vartësia e dikujt a e diçka-

je, të fitoj të drejtat që më përkasin. Pra, duhet të shikojmë përpara dhe duke mos harruar të kaluarën, por ajo në asnjë mënyrë të mos të na pengojë të ecim përpara.

Nëna e Baba, mësuesja apo mësuesi të bëjnë përpjekje maksimale të largohen vet në radhe të pare nga orientalizmi dhe pastaj të edukojnë fëmijët me anti-orientalizmin, sepse jo vetëm e kemi pasur këmbëkryq në jetën e të pareve tanë, por ne po vijojmë jo vetëm t'i kemi në tërë veprimtarinë tonë të përditshme këto mendësi, të cilat po na pengojnë të ecim përpara, por po edukojnë me këto mendësi fëmijët tanë. Pra, duhet të mësojmë thjeshtë këto fjale: Të lutem! Më fal! Faleminderit! Të mësojmë korrektësinë! Ju duket e çuditshme kjo që shprehem, por është një realitet, që po na dënon jo pak.

Të nderuar mësues e nëna, të bëjmë përpjekje të mësojmë fëmijët me detyrën që kanë në jetë, në çdo kohë të tyre, dhe të punojnë për ta realizuar atë, të ndërgjegjësojmë se kush realizon detyrën qytetare, të drejtat nuk i ka larg. Kjo, punë jo vetëm ndihmon në realizimin e misionit të shoqatës, por mbi të gjitha i mësojmë këta të ecin në jete me një ndërgjegjësim emancipues.

"Më shumë se sa fjala e shkruar apo e folur, është shembulli ai që udhëheq botën. Mund të vihet në dyshim çiltërsia e fjalës, por s'ka se si të mos besohet shembulli i dhënë. Fjala është e diskutueshme, shembulli flet vetë", theksonte **ImZot Gibier**.

Tri gjera nuk mund të kthehen kurrë mbrapsht: Fjala e thënë, shigjeta e lëshuar dhe e kaluara ... Prandaj duhet të jemi shumë të kujdesshëm në edukimin e fëmijëve, për ti emancipuar ata apo ato".

Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", i dha titullin "**Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini**", si me poshtë: Zotit **Edmond Tërthorja**, Zotit **Ndoc Vata**, Zonjës **Rovena Çuni**, Zonjës **Lena Ndrebatja**, Zonjës **Zoga Troja**, Zonjës **Drande Fiku Papeleka**, Zonjës **File Moshqeti**, Zonjës **Nusha Laçaj Gjeta**, Zonjës **Irena Fierza** dhe Zonjës **Lirjana Rama Çardaku**.

Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", i dha titullin "**Mirënjohja Martin Camaj**", poetes **Erenestina Gjergji Halili** dhe poetit e shkrimtarit **Anton (Ndoc) Papeleka**.

Takimi u mbyll me një koktejl të përgatitur me dashuri dhe bujari nga z. Zef Gjeta. Me urimet për shëndet dhe lumturi për mësuesit e zonjat, për suksese të tjera dhe në sa më shumë takime, u mbyll kjo veprimtari.

Përgatitur nga **Inxh. Gjon FIERZA**

MËSUESIT MISIONARË TË DIJES E KULTURËS

Dashuria për dije, ka ekzistuar në çdo kohë te çdo komb dhe ka shërbyer si rrugë për njohjen e jetës, për te gjetur shtigje te reja, për zhvillimin e të ardhmes. Ajo ka vazhduar dekada dhe shekuj, mes luftërsh dhe përpjekjesh, për njohjen e gjuhës, zakoneve e traditave, duke veçuar popuj dhe kombet nga njëri tjetri. E tillë ka qenë dhe rruga me plot luftra e përpjekje te patriotëve tonë për shkollën, gjuhën e kulturën shqipe edhe pse ajo ishte ndër me te vjetrat e gjuhëve te popujve europiane.

Treva jonë ka festuar para tre vitesh, 100 vjetorin e hapjes të shkollës parë për të lexuar e shkruar shqip, për të cilën jemi njohur përmes botimeve dhe veprimtarive të zhvilluara me atë rast.

Dukagjinasi janë dalluar për inteligjencë edhe kur atyre u mungonte shkolla. Lidhja e ngjarjeve dhe e datave, të luftërave e përpjekjeve për liri e pavarësi, të trashëgimit ndër breza të zakoneve dhe traditave, të interpretimit dhe krijimit të këngëve folklorike, me motive lirike, epike dhe legjendare, ku janë dalluar fshatra e individ të shumtë, njohje të shumë fenomeneve të natyrës përmes hënës dhe yjeve, përcaktimi saktë i riteve fetare, datëlindjeve, përvjetorëve te vdekjeve, ishte aftësi vetëm e njerëzve inteligjent.

Dihet se kleri katolik përmes kishës, ka qene kontribuuesi i parë i hapjes të shkollave dhe të mësuarit shkrim e këndim shqip, të malësorëve dukagjinasi, me kushte që tani është zor të imagjinohen. Nuk dua të ndalem shumë në historikun e shkollës në

zonën tonë, se tashmë dihet, por të përmend disa aspekte të rrugës time si mësimdhënës për 44 vjet ne Dukagjin dhe Tiranë, të cilat mua me duken të vecanta dhe me interes, ti përshkruaj shkurt.

Kujtoj fillimet e viteve 60 kur unë jam ulur në bankat e shkollës, ku mungonte drita elektrike mjetet elementare për një mësim normal, por dashuria për shkollën, për dijen ishte shumë e madhe. Mësuesit e asaj kohe që punonin në fshatin tim Theth megjithëse ishin jabanxhinj të ardhur nga qyteti i Shkodrës, ishin shumë të përkushtuar, të kualifikuar me arsim përkatës profesional, të dashur me nxënësit dhe te respektuar në bashkësi. Ata ishin për ne nxënësit e asaj kohe, njerëzit me të përsosur deri dhe të veçantë, duke u bërë frymëzim dhe shtytës që unë të kërkoj, të dua e të vazhdoj profesionin e respektuar të mësuesit.

Thënja se si janë mësuesit është shkolla, si është arsimit, dija e kultura, si janë këta faktorë është zhvillimi i një vendi e përparimi i një kombi.

Zhvillimi i arsimit ne Dukagjin, mori zhvillim të rëndësishëm në çdo fshat e zonë, duke u investuar në infrastrukturë, në plotësimin me kuadër të kualifikuar me prioritet atë vendas. Dashuria për shkollën e dijen, geni dukagjinasi i inteligjencës, shkëlqeu dhe kapi majat më të larta të arsimit dhe kulturës shqiptare, që nga klerikët, shkrimtarët, poetët, aktorët, piktorët, kuadrot e tjerë, që janë të shumtë ndaj nuk po i veçojmë, qenë dukagjinasi të veçantë dhe të paarrtshëm. Zhvillimi, sh-

trirja, cilësia, masiviteti i arsimit në Dukagjin nga vite 60 deri në fillim të viteve 90 qe i vrullshëm. Kështu nëse i referohemi statistikave në fillim te vitit 1990 në Dukagjin kishte

Gjithsejt 54 shkolla, nga këto 5 të mesme, 20 tetëvjeçarë, 29 fillore, me 4445 nxënës dhe 243 mësues në të tre ciklet. Vetëm Thethi kishte shkollë të mesme, 8 vjeçare, fillore me 174 nxënës. Tani në këtë shkollë frekuentojnë 12 nxënës me dy mësues. Kudo në Dukagjin tani ka pak nxënës, pak mësues dhe në rritje numri i analfabeteve.

Ndryshimi i sistemit, lëvizja demografike, bëri që banorët dukagjinasi për kushte më të mira jetese, të shpërnguleshin drejt zonave urbane, dhe të emigrojnë jashtë vendit, jo vetëm në Evropë, por dhe në shumë shtete te botës. Është e rëndësishme që fëmijët e dukagjinasi, në shumë raste po shkëqejnë dhe janë ekselent, si brenda dhe jashtë atdheut.

Ndryshime të shumta kanë ndodhur në krejt procesin e punës në shkollë, si në organizim, drejtim, formë dhe përmbajtje. Sot pak lexohet libri, por interneti, telefoni, nga të cilët merret informacion i gatëshëm. Duke mos lexuar libra nxënësi nuk mund të krijojë, të ritregojë, të riprodhojë, të shprehet lirshëm me fjalë e shprehje, sipas moshës, kërkesës te programit dhe nivelit te shkollave. Mungesa e bibliotekave, e laboratorëve dhe e mjediseve ku nxënësit marrin njohuri praktike, duke veçuar prirjet, talentet për të ardhmen, shkolla bëhet e merzitëshme,

monotone, rutinë dhe me interes ne rënjë. Vetë ndryshimet që kanë ndodhur, në format dhe metodat mësimdhënjes, përmes reformave të shumta, kanë shtuar formalitetin dhe burrokracinë, duke e mbingarkuar mësuesin, duke e bërë të largohet nga misioni dhe përgjegjësia si mësimdhënës. Kjo ka ndikuar dhe në rënjën e cilësisë që po vjen në rritje, në çdo nivel të sistemit tonë arsimor. Këtë po e shohim në media, institucione, televizione shtetërore e private.

Mësuesi në çdo kohë mbetet në qëndër të përgjegjësishë të punës dhe arritjeve në arsimin tonë. Puna e tij krahasohet me qiriun, që lëshon dritë, jep dije e mirësi për brezat gjatë gjithë karrierës, në misionin fisnik të edukimit.

Unë ruaj kujtime gjatë punës time në Dukagjin, por dhe mbi 20 vite në Tiranë nga ish koleget e mi nga me te bukurat, interesantet dhe mbresëlënëset. Ndaj respekt e mirënjohje për gjithë ata që kontribuan dhe kontribuojnë në frontin e bukur por shumë të rëndësishëm të arsimit dhe edukimit. Në veçanti homazhe për ata që janë ndarë nga kjo jetë, për kontributin tyre ne sektorin e arsimit në Dukagjin, që ishte i madh, cilësor dhe vendimtar.

Kurdoherë do të ketë shkolla, nxënës, libra, forma e metoda, reforma e eksperimente, por mësuesi i përkushtuar do të mbetet, në kujtesën e brezave të nxënësve dhe të mësuesve, të vlerësuar dhe model pozitiv në frontin e dijes.

Gëzuar 7 Marsin mësues!

Gëzime, mbarësi e arritje paçi në çdo drejtim të jetës tuaj!

ZEF BARI, Tirane, 8 Mars 2020

LUFTA KUNDËR KRIMINALITETIT KËRKON MOBILIZIM NGA TË GJITHË E JO VETËM NGA POLICIA

- kronikë -

Në ditën e fundit të muajit shkurt, Shoqata Atdhetare "Dukagjini" në bashkëpunim me drejtorinë e policisë në Shkodër, bashkinë Shkodër dhe Prefekturën e Qarkut Shkodër, organizuan një tryezë të rrumbullaktë në lidhje me punën që duhet bërë për eliminimin e drogës dhe veprimtarinë kriminale në krahinën e Dukagjinit, qëllimi i të cilës ishte: "Të bëhen përpjekje për të parandaluar mbjelljen e përdorimin e lëndëve narkotike, ti shmangemi sa të jete e mundur nga kjo e keqe e madhe".

Merrnin pjesë përfaqësues Sekretarja e Përgjithshme të Prefekturës, zonja Feleke Kasemi; N/kryetari Bashkisë Shkodër, zoti Arben Gjuraj; Z/ Drejtori i Rendit Shkodër, zoti Dashamir Spaho; drejtuesit e njësive administrative Shalë dhe Shosh, përkatësisht Petrit Arra e Ndoc Ashta, kryepleqtë e fshatit Theth (Marash Rrgalla), Abat (Preke Maci) dhe Gjuraj (Gege Tefaj); drejtori i shkollës 9 vjeçare "Dede Gjon Luli", në Hot të Ri Gjovalin Kodra dhe veprimtar të Shoqates Atdhetare "Dukagjini". Ishte Konsulli i Nderit të republikës së Austrisë dhe N/kryetari i Shoqatës, zoti Gjergj Leqejza. Ishin të pranishëm edhe shumë gazetarë të medias elektronike të Shkodrës.

Në këtë bashkëbisedim u referua një

temë dhe disa trajtesa:

- Shqetësimi, që është krijuar me mbjelljen e lëndëve narkotike dhe pasojat përkatëse, nga Zoti Ndue Sanaj.

- Përparimi ekonomiko-shoqëror, mundësia kryesore për uljen dhe zhdukjen e kriminalitetit, nga Luigj Shyti.



- Puna e shkollës për edukimin e fëmijëve për kundër përdorimit të lëndëve narkotike, përgatitur nga Gjovalin Kodra e Tereze Brigja, referuar nga Gjovalin Kodra.

- Roli negativ në varfërimin e kontaminimin e tokës bujqësore, kultivimi i bimëve narkotike si rezultat i zhvillimit intensiv të rritjes së këtyre bimëve, përgatitur nga Prof. Dr. Zef Gjeta e Gjon Fierza, e referuar nga Profesor Dr. Zef Gjeta.

- Detyra e policisë së shtetit në bashkëpunim me bashkësinë për parandalimin e kultivimit e përdorimit të lëndëve nar-

kotike, nga Z/drejtori i Rendit Shkodër, zoti Dashamir Spaho

Në temat që u paraqitën u bë analizë në mënyrë të studiuar për gjendjen jo vetëm të drogës, por edhe faktorëve që shtynë në drejtim të saj, por edhe në elementë të tjerë kriminal që janë shfaqur në këtë zonë dhe që vitet e fundit ka pasur një rritje. Gjatë paraqitjes së temave u bënë edhe propozime konkrete për masat për uljen dhe largimin nga kriminaliteti në këtë krahinë.

Pastaj e morën fjalën edhe disa nga pjesëmarrësit, të cilët në diskutime dhe mendimet e tyre dhanë mendime për forcimin e punës në luftën kundër drogës, prodhimin dhe përdorimit të saj. Edhe në temën dhe trajtesat që u publikuan, por edhe në diskutimet e të pranishmëve u shtrua problemi i rrugës kryesore për të larguar njerëzit nga rruga e krimit dhe kriminaliteti.

Të gjithë dolën në një drejtim shumë të rëndësishëm që është rritja e mirëqenies ekonomike-shoqërore. Por për këtë duhet që shteti dhe shoqëria të punojnë përkrah njëri tjetrit për ta integruar këtë territor, dhe mundësitë janë për më shumë punësim, për të vihen në shfrytëzim mundësitë jo të vogëla të kësaj zone për të rritur të ardhurat për çdo familje. Problemet e edukimit janë dhe duhet të jenë në një shkallë shumë më të lartë. Kthimi i syve dhe mendjes ndaj kësaj zone është domosdoshmëri, sepse kjo do të largonte dhe shpëronte këta njerëz, këto familje, këtë zonë nga e keqja. Por duhet thënë se nga trajtimi i problemeve nuk shpëtojnë nga përsëritja e diskutimeve, pa thënë nëse jam apo jo dakord me parafolësit. Kjo don të thotë se "duhet ta them unë që të zejë vend", e të tjera.

Edhe gjatë këtyre diskutimeve u duk

fenomeni i mos marrjes përsipër të detyrave dhe punë konkrete, por pothuaj të gjithë jepnin mendime dhe detyra për të tjerët. Këtu bën përjashtim vetëm përfaqësuesi i policisë, i cili publikoi veprimtarinë e policisë në të ardhmen në drejtim të krimeve dhe kriminelëve. Gabimet dhe fajet, sipas disa diskutantëve, i kishin të tjerët, sikur nuk jetojmë në këtë teren. Nuk nxirren gështenjat me gishtat e të tjerëve. Po deshe të hash gështenjat le të digjen pak edhe gishtat. Askush nuk duhet të përpiket që të heqin gështenjat nga zjarri me duartë e të tjerëve sepse tashmë nuk janë më në atë nivel bashkëpunorët, kolegët, bashkësia, që të mos kuptojnë dhe veprojnë. Të diskutosh dhe tu kërkosh detyra të tjerëve është e lehtë, por e rëndësishme është të marrësh vetë përsipër detyra dhe ti zgjidhësh. Nuk realizohen detyrat dhe mbahet karrigeja duke shtrirë gishtin te të tjerët ose duke bërë rolin e viktimës.

Është e rëndësishme të thuhet se edhe në këtë tryezë me shumë rëndësi duhet të merrnin më shumë pjesë nga gjysma tjetër e popullsisë. Ishin vetëm dy gra, kuadro të cilat e justifikuen veten, por si edhe në shumë takime e diskutime të tjera, mund të konsiderohen vetëm mbledhje burrash. Është e novojshe me të marrin pjesë edhe ajo pjesë e popullsisë, nënat, motrat, bijat, sepse janë shumë, dhe janë të ndjeshme dhe të mundshme për të ndikuar pozitivisht, sepse është shumë e nevojshme që edhe ato të ndihmojnë në uljen e kriminalitetit, por edhe në gjithë jetën shoqërore.

Gjithsesi kjo tryezë e organizuar nga Shoqata Atdhetare "Dukagjini", ja arriti qëllimit, dhe do të vlejë për të ardhmen, e do të ndikojë fort në uljen e kriminalitetit dhe ndryshimin e imazhit me drejtim pozitiv të kësaj zone.

Luigj SHYTI, mars, 2020

7 MARS DHE HISTORIA E SHKOLLËS SHQIPE

Në kalendarin e festive shqiptare, 7 Marsi ka zënë një vend të vetin: për çdo vit festojmë në këtë datë, “Ditën e Mësuesit” që përkujton ditën kur u hap e para shkollë shqipe në Korçë: më 7 Mars 1887. Si nxënës e student kam dhënë shumë urime në këtë datë, por si mësimehënës prej shumë vitesh, edhe kam pasur kënaqësinë të marr mjaft urime. Hapja e mësonjëtores në Korçë ishte një ngjarje me rëndësi të veçantë duke shfaqur një dritë në atë errësisë të kohës. Në këtë kontekst, nuk kam asnjë gjë për të kontestuar për datën 7 Mars, por vetëm me emërtimin e saj. Për hir të së vërtetës, data e hapjes së shkollës së parë shqipe është mjaft më e hershme.

Me 7 mars 1827 lindi Kostandin Kristoforidhi, një fakt mjaftueshëm i rëndësishëm për të caktuar 7 marsin si dita e mësuesit. Por, kur thonë 7 Marsi, dita e hapjes së të parës shkollë shqipe në Shqipëri, nuk më rrin mirë. Kjo pasi historia e arsimit shqip është dukshëm më e hershme dhe e pasur me evente që përbëjnë gurë kilometrikë në arsimin shqip.

Para se të ulesha për të shkruar këtë material, kam menduar gjatë, kam sjellë në mendje gjithë artikujt e librat që kam lexuar që lidhen me arsimin në Shqipëri, e së fundmi kam lexuar edhe shkrimet e autorëve: Prof. Sami Repishti, Ndue Dedaj, Ilir Seci, Isak Ahmeti, etj. Nga njëri prej tyre kam shkëputur citimin: “Historia e arsimit tonë është një histori luftash, përpjekjesh, histori e një populli të vogël në numër, por të madh në botën e tij shpirtërore, në vullnetin e tij për të qenë i lirë dhe i pavarur”.

Nëse “zhytemi” në Bibliotekën Kombëtare apo në ato të rretheve, nuk arrin të gjej një botim përmbledhës që të ketë marrë përsipër edhe të tregojë me fakte, me dokumente dhe në mënyrë bindëse historinë e arsimit në Shqipëri. Edhe në botimet që kanë marrë përsipër historinë e popullit shqiptar, arsimit as nuk zën pjesën që meriton, e aq më pak të arrijnë të na japin të qartë rrugën që ka ndjekur arsimit në Shqipëri, në territoret që përfshihen në RSh, aq më pak, nëse marrim në konsideratë trojet arbnore, ku kanë jetuar e jetojnë edhe sot shqiptarët.

Në ato botime zyrtare (sëpaku në ato që unë kam pasur mundësi të kem në dorë), nuk përmenden shkollat e hapura në mesjetë apo edhe më parë, por vazhdohet me tezat e vjetra ku përqëndrohet vëmendja dhe i bëhen elozhe vetëm shollës së Korçës.

Kam arritur të gjej shkrime që bëjnë fjalë për një shkollë në Shqipëri për vajza dhe djem që u ndërtua në Korçë 500 vjet më parë nga themeluesi i saj, Iljaz bej Mirahori. Deri më sot si shkolla më të hershme të vendit janë përmendur shkolla e fshatit Velë në Mirditë, ndërtuar më 1632, shkolla e Pllanës më 1638, e Troshanës më 1639, e qytetit të Shkodrës më 1689 etj. Por, rreth 475 vjet më parë janë hapur shkollat e parë shqipe në Kosovë. Edhe atëherë kur persekutimi i arsimit shqip nga autoritetet osmane ishte i ngritur në sistem, në Stubëll, fshat i Malësisë së Karadakut, që shfaqet më 1555 dhe në një defter osmano-turk, më 1584 fillon tradita e arsimit shqip, i pari dhe i vetmi rast

atëherë në Kosovë. Por, unë kam rezerva në lidhje me kërkimet, studimet apo edhe botimet që lidhen me arsimin në Shqipëri dhe historinë e tij, vijimësinë e arsimit në trojet shqiptare.

Mbi shqiptarët kanë kaluar stuhitë e shumta dhe rrallë mund të ketë ndonjë popull në botë që të ketë pasur pushtime dhe pushtues kaq të egër, aq barbar e më kohëzgjatje kaq të madhe, siç kanë njohur shqiptarët. Por, pavarësisht kësaj, patriotët dhe veprimtarët e shqiptarisë gjatë gjithë jetës punuan për kombin dhe vendin duke u përpjekur me të gjitha mënyrat që të sigurojnë mbijetesën njerëzore, mbajtjen dhe trashëgiminë e gjuhës, ruajtjen dhe trashëgiminë e traditës. Lidhja e përhershme me ambientin e jetës shqiptare, ashtu si dhe përkushtimi shpirtëror i tyre dominuar lëvizjet e patriotëve shqiptarë në kohë të ndryshme, të cilat sipas historisë kishin ulje ngritjet e veta, por asnjëherë nuk u ndalën. Në kushtet shumë të vështira që iu imponuan shqiptarëve, nga gjiri i popullit shqiptar dolën një varg atdhetarësh të flaktë që iu përveshën punës për përhapjen e arsimit shqip në popull dhe për krijimin e shkollave në gjuhën amtare.

Sipas të dhënave që mund të gjenden, duket se tradita e shkollave shqipe të shekullit të XV-XVI, do të vazhdonte të përforcohet dhe të pasurohet veçanërisht në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, kur në disa qendra të njohura të shqiptarizmit, si në Korçë, Shkodër, Prizren, Pejë, Gjakovë, Zym, Janjevë dhe Stubëll, u hapën dhe rihapën shkolla shqipe duke u bërë vatra të vërteta jo vetëm të arsimit dhe të edukimit, por edhe të lëvizjes sonë kombëtare.

Një farë “liste” të shkollave shqipe që kam arritur gjej (pa pretenduar një kërkim shterues), janë si në vijim:

- shkollën në Ulqin (1258)
- në Durrës (1278), dy shkolla
- në Shkodër (1345 dhe 1395),
- Tivar (1349),
- Pult (1367),
- Drisht (1396),
- duke vazhduar në shekujt XV-XVIII me shkolla të tjera në Shkodër, Lezhë, Stubëll (1584), Trafandinë, Kunavi, Dibër, Prizren, Shkup, Elbasan, Ohër etj.

Botimet dhe shkollat e para shqipe janë prirë e mbajtur gjallë nga ipeshkvijtë shqiptarë: Pal Engjëlli, Nikollë Mejkashi, Gjon Kolesi, Mark Skura, Frang Bardhi, Gjergj Bardhi, Pjetër Budi, Pjetër Bogdani, Gjergj Uldanji, Nikollë Vladani, Shtjefën Gaspri, si dhe mësuesit: Gjon Shqiptari, Filip Shkodrani, Dhimitër Dhërmiu, Fra Kerubini, Pater Karli, Dom Prenga i Troshanit, Dom Martin Bushalla i Durrësit, Dom Pjetër Perlati i Mirditës etj. Një traditë që vinte nga shekulli XV, me humanistët shqiptarë në Rilindjen Europiane, gjer profesorë në Universitetin e Padovas, si Gjon Gazulli etj.

Megjithëse tashmë kanë dalë këto fakte të përmendura më lart, në historinë e zhvillimit të shkollave shqipe dhe të arsimit tonë kombëtar, rrënjët e edukatës dhe të arsimit tonë kombëtar i gjejmë që në lashtësinë e hershme, si pikënisje meriton mësonjëtorja e Korçës që filloi të punojë me 7 mars 1887, me mësuesin e saj

Pandeli Sotiri, të cilin e pason shkolla e Prizrenit në vitin 1889, me mësuesin Mati Logoreci.

Edhe përsa i takon patriotëve që sakrifkuan për shkollën, ashtu edhe për mësuesit / mësimehënësit, jemi të kufizuar në pak emra si: Pandeli Sotiri, Papo Kristo Negovani, Petronino Luarasi, Motrat Qiriazhi, Mato Logoreci, Gjeqovi e shumë të tjerë. Prandaj, brezi ynë sot me krenari, dashuri e respekt i kujton emrat e tyre. E më pas, më të rinjtë që punuar në kushte të vështira të pushtimit, të përndjekjes nga “komshinjtë” shovinistë e më mrendime territorial, ashtu edhe të tjerë të persekutuar nga sistemi totalitar, nuk e kemi të mundur ti gjejmë të renditur, nuk kemi të dhënat e duhura për to.

Ka patur iniciativa individuale të studiuesve të ndryshëm, për të hedhur dritë sado pak në historinë e arsimit shqip. Një ndër to, At Donat Kurti, në një studim të botuar në revistën “Hylli i Dritës” më 1935, ku flet për të parën shkollë shqipe të hapur më 1638. Si të parat shkolla “për sa dijm na” ai përmend shkollat e Pllanës, e Blinishtit dhe e Shkodrës. Për të parën ai thotë se është hapur më 1638. Ndërsa studiuesi amerikan Edwin Jacques në librin e tij të njohun “Historia e Popullit Shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme” (The Albanians: An Ethnic history from Pre-Historic Times to the present) i daton shkollat e para shqipe më përpara në kohë: në vitin 1632, në zonën e Velës në Mirditë. Por një tjetër shkollë e hershme është edhe ajo në Kurbin, e vitit 1632. Në këto shkolla përveç shkrimit e leximit, aty mësohej edhe gramatika shqipe dhe përdorshin librat e Frang Bardhit, Pjetër Bogdanit dhe Pjetër Budit. E. Jacques shton se një tjetër shkollë u hap në Pllanë, një fshat afër lumit Mat me 1638, në Troshan afër Lezhës më 1639 dhe në vetë qytetin e Shkodrës më 1698.

Nga dokumentet e dala në dritë nga studiuesi Injac Zamputi, del se Ipeshkvi i Arbnisë, Imzot Gjon Kolesi (franceskan shqiptar), në vitin 1625 shpall para Selisë së Shenjtë nevojën e “ngrehjes” së një a dy shkollave në malësitë e dioqezës së vet (zonë në të cilën përfshiheshin edhe kishat e Krujës, Kurbinit, Matit, Lurës, Dibrës, përfshiheshin famullitë mirditore të Kthellës, Selitës e Rranzës) “me nga 10-12 djem secila”, ku nxënësit “të mësonin shkrim e këndim dhe themele të mira të besimit”. Pastaj, të shkolloheshin më tej jashtë vendit, në Loreto (Itali), “sepse kësh-tu do të nxirrej fryt i mrekullueshëm n’ato vende ku s’ka shkolla e as mësues”. Dhe më e rëndësishmja: “mbasi të kenë nuanë për vete, do të bahen mësues për të tjerët”.

Bazuar në disa kronika të kohës, mësojmë se në vitet 1628–1661, shkolla shqipe me germa latine u hap në Dhërmë të Himarës dhe më vonë edhe në disa qendra të tjera të krahinës. Edhe në zona të tjera si në Voskopojë, në Kosovë, e në qendra të tjera – vatra të shqiptarizmit janë hapur shkolla (në fakt klasa) ku janë hedhur hapa konkrete në të mësuarin e shkrimit shqip.

Në një artikull të botuar në lidhje me situatën e zhvillimit të vendit para pushtimit otoman, kam gjetur se ne: “Kishim një Universitet në vitin 1380 në Durrës.

Qe te krijoni idenë: Gjermania e ka hapur universitetin e parë 6 vjet pas Durrësit (Heidelberg University). Kishim filozofët tanë humanistë që bënë “kërdinë” në Europë me idetë e tyre dhe ishin këshilltarë të familjeve perandorake në Hungari, Itali dhe Austri. (Gjon Gazhuli, Pal Engjëlli, Leonik Tomeo dhe Gjon Durrsaku)”.

Morëpo, sot ne nuk kemi (ose kemi një numër shumë të limituar) të botimeve të kohëve të mëparshme të cilat janë e nuk janë të njohura për ne sot. Për të analizuar këtë gjë, duhet të mbajmë në konsideratë mënyrën e të shkruarit, mënyrat që përdorshin për botim dhe në mënyrë shumë specifike: në sa kopje botohej një material i shkruar, një letër, broshurë a libër?

Duke i marrë parasysh këto vështirësi (materiali në të cilën shkruhej, mjetet me të cilat shkruhej, jetëgjatësia dhe rezistenca e materialit), por edhe lloji i germës së përdorur, del fare qartë se nuk ka qenë e nuk është e lehtë të kemi gjithë dokumentet e nevojshme për të krijuar një tablo të qartë për ecurinë e arsimit në vend.

Gjithësesi, janë një sërë gjerash për tu sqaruar:

- A u ruajt gjuha shqipe nga pellazget, tek ilirët e deri në ditët tona vetëm në mënyrën e folur?

- Si u bë e mundur që të përktheheshin veprimtaritë shqiptare, që nga feja e deri tek marrëveshje të tjera?

- Si u shkruajt Kanuni dhe si u transmetuar në vijimësi? Mos vallë vetëm në memorien dhe të folurën e popullit?

- Si vepronin të huajt në trojet tona kur vizitonin vendin, kur bënë tregëti, kur ndërtonin marrëdhënie të ndryshme, që kanë mbetur në histori?

Nga ana tjetër, unë kam disa pyetje që më lindin në lidhje me historinë e arsimit në Shqipëri:

- Kur historiografia shqiptare do të fillojë të bëjë analiza, studime e botime të bazuara tërësisht në fakte, të dokumentuara dhe të referuara, kur në fakt do të kemi mundësinë të lexojmë një material sa më të plotë (mundësisht shterues për kohën) në lidhje me arsimin në trojet shqiptare?!

- Kur arkeologjia dhe studiuesit e kësaj fushe do të ndërmarrin studime të dedikuara arsimit, gjurmëve të mbetura e të trashëguara deri në ditët tona, të na japin fakte rreth gjurmëve të arsimit në vend dhe të adresojnë periudha kohore të sakta?!

- Kur Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë do të ndërmarrin studime të plota, të bazuara tek arkeologjia, historiografia, e gjithë burimet e tjera që të na japin një panoramë të plotë me fakte dhe dokumente në lidhje me rrugën që ka ndjekur arsimit në vend.

Nuk e di kush mund të më sqarojë në lidhje me gjerat që shtrova më lart për tu sqaruar, si dhe me pyetjet e shtruar. Megjithatë, do të më pëlqente që kur përmendim apo i referohemi 7 Marsit, ti referohemi si festa e mësuesit, si përkujtim i kalvarit të përpjekjeve për arsimin shqip, si përkujtim dhe respekt i punës së mësuesve në histori, dhe jo si përkujtim i hapjes së të parës shkollë shqipe në Shqipëri.

Përgatitur nga
Prof. As. Dr. Zef GJETA

SHQETËSIMI, QË ËSHTË KRIJUAR ME KULTIVIMIN E PËRDORIMIN E LËNDËVE NARKOTIKE DHE PASOJAT PËRKATËSE

Në shkollën e mesme, dikur na është bërë e ditur se në imperializëm për të vu në gjumë masat dhe në veçanti rininë përdorin lëndë narkotike, që ata të mos ngrihen në këmbë për të drejtat e tyre. Në një roman, me titull "Guxo ...!", me autor dramaturgun Fadil Kraja, shkruhet, që edhe në kohën e Monizmit është mbjellë lëndë narkotike për eksport në drejtim të vendeve Perëndimore, megjithëse besoj, se nuk ka qene e vërtetë. Kuadro të bujqësisë dhe të sigurimit të shtetit së asaj kohe nuk e pranojnë. Pak rëndësi ka kjo, se sa është e vërtetë, por ka rëndësi, se është njohur që atëherë lënda narkotike.

Pas viteve 1990, rreth vitit 1995 e më pas lexuam në median e shkruar e dëgjua në mendja televizive, se Lazarati qendra e kultivimit të lëndëve narkotike dhe habiteshim, se si është e mundur!? Por, ja ishte e mundur, se kultivimi i tyre, më vonë u bë në mbare hapësirat shqiptare, sa tani është kthyer në organizate kriminale, është kthyer në krim, në vrasje, në përdhunim. Pra, në qoftë se në fillimet e saj habiteshim, tani është kthyer në shqetësim individual dhe deri nacional e ndërnacional.

Ketë shqetësim, kryesia e shoqatës nuk e ka kaluar në heshtje, se studiuesi, poeti, publicisti dhe N/kryetari i shoqatës, Prele Milani, e ka prezantuar në gazetën "Dukagjini", nr. 186, në muajin prill 2019,

me titull "ME RAMËN E PA RAMËN, ME BASHËN E PA BASHËN, ME ZGJEDHJE E PA ZGJEDHJE, JO MË KANABIS!

Prela shqetësimin e tij, dhe të kryesisë e fillon: "Pas këtyre shirave të shumtë, papritur vera doli dy javë para Shën Gjergjit, i njohur si shenjtori i stinës më të dashur të njerëzisë. Vera erdhi e mirëpritur e krahëhapur. Ardhsia e bardhë dhe e shkretë pa bimën më të re, e më të shëmtuar të florës shqiptare. Stina e "arit të blertë" kurrë mos lulëzofte më! Sahara u bëftë për të toka shqiptare! Mallkuar në jetë të jetëve katili që e pjellë këtë kolerë të përbotshme, e cila dehu e marrosi Shqipërinë e mjerë djathtas e majtas nga koka te këmbët ...".

Sigurisht fjala e shqetësimi ishte për mbare hapësirat shqiptare, por kryesisht për shtrirjen gjeografike të Dukagjinit, se atje, siç thoshte Koliqi ynë: "Nuk shkeli këmbë tjetër veç asaj të mbathur me çorape dhe opinga të malësorit".

Po, Prela me poshtë shkruan: "Ato podina të qëndisura me gjelbërim pyjesh e livadhesh të mëndafshita, rrethuar me kordonë ka mbi 20 vjet që janë mbuluar nga një re e zezë vampirë, që ka ulur në gjunjë krenarinë dhe betimin historik: "Unë jam shqiptar dhe Zot në vendin tim! Jetoj si çetina e ngulur në shkëmb, në zgrip jo për një grusht, por për dy gisht

fytyrë". Asnjë specie invaduese nuk i ka sjell rrënim më të madh ekonomik Dukagjinit se "Luci Ferri" i veshur me petkun e kamufluar të "Luci Dritës". Asnjë sistem politik që "lulëzoi" apo pllakosi këtë krahinë tash 107 vjet, nuk solli një rrenim moral më të shëmtuar se "Shën Hashashi". Kryqet e varreve që bëjnë hije mbi kryet e tatave dhe lokeve tona sokolesha, askush nuk i shëmtoi me blasfemi të tillë si paganët e ndërkrayer, që pushtuan malet më bimën e djallit".

Dhe jo vetëm kaq, që më mirë do të ligjërojnë specialistet me trajtesat e tyre, por kjo epidemi nuk u ndal me kaq, por kaloi në marrje jete të njeriut. Me 15 shtator 2016 u vra Gjak Pjeter Arra, në Gjuraj të Pultit. Me 21 tetor 2019 u vra Lazer Pjeter Arra në Palaj të Shoshit dhe me datën 6 nëntor 2019 u vra Gjergj Simon Krygja nga fshati Sume, të Pultit. Për këto dy vrasjet e fundit, unë kam shkruar një artikull, në gazetën "Dukagjini", nr. 193, në muajin nëntor 2019, me titull "DY TRAGJEDI TË TJERA DUKAGJINASE" Në muajin janar të këtij viti kalohet në veprime primitive deri në terrorizëm duke venë lende plasëse personave dhe terrorizuar familjet, në Grude të Re e gjetke dhe duke djegur shtëpi e prere pemë të familjeve në Plan.

Arritja deri në këto veprime besoj, se komentet e mëtejshme janë të tepërta.

Por, më vjen shumë keq, deri në mos besim ta theksoj, se megjithëse janë shkruar për këto shqetësime dhe për këto pasojat, pjesa dërmuese e intelektualëve e të shkolluarve dukagjinas rrinë në heshtje, mbajnë qëndrim indiferent, për të cilat duhet të ulërinim e të ngrihem në këmbë për të dale nga kjo gjendje me çdo kusht.

Pra, shqetësimi jo vetëm në zonën e Dukagjinit, në krahinat e saj është mjaft evident, por dhe në hapësirat e tjera të bashkisë Shkodër, të bashkisë Vau Dejës e të Qarkut Shkodër, për të cilat duhet të shqetësohet secili qytetar duke njohur në radhe të pare detyrën e tij, dhe të punojë për realizimin e detyrimeve, që dalin prej saj. Njëkohësisht të njohe të drejtat dhe të bëj përpjekje për ti plotësuar ato. Gjithashtu duhet të ndërjegjësohem, se kush zbaton detyrën, të drejtat nuk i ka larg.

Lind, pra pyetja e thjeshtë, për qytetarin e thjeshtë e deri te ai që ka detyra shtetërore me ligj, për të luftuar ketë murtaje, për të parandaluar kultivimin e përdorimin e lëndëve narkotike, e bën detyrën e tij?

Zonja e zotërinj në këtë takim dhe jashtë tij, të gjithë të ngrihem në këmbë e të zbatojmë detyrimet qytetare e ligjore!

Ju faleminderit!

Ndue SANAJ,

Shkodër, me 29 shkurt 2020

PUNA E SHKOLLËS PËR EDUKIMIN E FËMIJËVE PËR KUNDËR PËRDORIMIT TË LENDEVE NARKOTIKE

Një nga problemet më të mëdha të shoqërisë shqiptare është përdorimi i drogës në shkolla.

Edhe pse nuk ka kërkime sistematike rreth toksikomanisë, në Shqipëri nga përvoja e deritanishme fenomeni i përdorimit të drogës në shkolla, përben një emergjence të madhe.

Përdorimi i drogës në shkolla në përgjithësi është në arsimin e mesëm, por nuk përjashtohen në shumë raste edhe në shkollat 9-vjeçare.

Pse po rritet numri i përdoruesve në shkolla dhe cilat janë arsytet:

1. Mungesa e sigurisë dhe e disiplinës .
2. Kureshtja dhe dëshira e fëmijës për të provuar diçka të re.
3. Ikja nga monotonja për tu ndjere ndryshe.
4. Traumata e ndryshme që fëmija mund të ketë pasur .
5. Mungesa e kujdesit të prindërve dhe mësuesve .
6. Bindja e gabueshme se përdorimi i radhë nuk të çon në varësi.
7. Mungesa e njohurive mbi demin e tije.
8. Dhënia falas nga shitësit e drogës.
9. Për tu bërë pjesë e shoqërisë
10. Mungesa e psikologut dhe e punonjësit social

Të gjitha këto e shumë të tjera janë disa nga arsytet se pse përdoret dhe pse po rritet përqindja nga viti në vit i përdoruesve .



Shkolla si institucion ka përgjegjësi shumë të madhe për kujdesin e fëmijës për mospërdorimin e drogës dhe në mënyrë të veçantë për sensibilizimin e mbi demet që sjell përdorimi i tij .

Në shkollat tona Hot i ri, Bardhaj ku

shkollat janë nen shikimin tonë non stop të kamerave të sigurisë është shumë e vështirë, që të konsumohet drogë e tipit ashshash që është me popullorja pa rënë në sy të mësuesve dhe të nxënësve .

Angazhimi i Qeverisë nxënësve dhe i mësuesve kujdestare në veçanti duke qëndruar shumë afër nxënësve, duke zvogëluar në maksimum qëndrimin e vetmuar ka dhënë një efekt pozitiv në këtë drejtim.

Për t'ju përgjigjur shumëllojshmërisë së nevojave është një domosdoshmëri që të shtohen shërbimet, të cilat duhet të jenë të shumëllojshme të dobishme dhe ndërvepruese për të dhënë një mesazh të njëzëshëm:

- a) Të ulim braktisjet e momenteve dhe boshllëqet e kohës së fëmijëve në shkollë.
- b) Reagim i fortë dhe i shpejtë dhe i integruar i policisë së shtetit .
- c) Reagim i shkollës dhe i mësuesve .
- d) Reagim i prindërve dhe informimi i tyre në kohë.
- e) Prania e psikologut për çdo shkollë për të vlerësuar nxënësit dhe gjendjen e tyre.
- f) Studime rreth toksikomanisë dhe zbatimi i metodave bashkëkohore evropiane .
- g) Reagimi i mediave shikuese dhe të

shkruar.

h) Reagimi i shoqërive civile siç po reagon Shoqata Atdhetare "Dukagjini".

i) Mbështetje akademike për vetëkontrollin e ndërjegjësimin emocional.

j) Hartimi i planeve komunitare afatgjata për parandalimin e drogës tek adoleshentet.

Vonesa në ndërhyrje për parandalimin e përdorimit të drogës në shkolla do ta bëjë me të vështirë për të zvogëluar rreziqet ndaj sajë .

Në adoleshencë, qëndrimi i fëmijës dhe sjelljet janë të krijuara dhe nuk ndryshojnë lehtë .

Sa më shumë të jetë i shfaqur fëmija ndaj rrezikut, aq më shumë ai do të abuzojë.

Në një mjedis me moshatare jo abuzues me drogën, i riu ka më pak mundësi të bëhet abuzues droge dhe prania e shumë faktorëve mbrojtës mund të minimizojnë im faktin e disa faktorëve të rrezikut.

Të gjithë duhet të kemi një detyrë parësore, që të punojmë për minimizimin e përdorimit të saj në adoleshencë.

Shkolla nuk mund të riparojë të gjitha të këqijat e shoqërisë, por ajo ka për detyrë të riparojë të keqen e injorancës.

Gjovalin KODRA

Drejtor i shkollës

9 vjeçare "Dede Gjon Luli",

në të Hot i ri.

29 shkurt 2020

PASOJAT NGA PËRDORIMI I SUBSTANCAVE NARKOTIKE NË FAMILJE

“Mos të kesh të hash e të pish, nuk kam frigorifer, as televizor, nuk kam asgjë. Marr borxhe nëpër lagje, tek marketi, tek buka por me çfarë do t’i laj. Ose do të shes diçka nga shtëpia ose do të detyrohem të dal e të vjedh...Ngrihem në mëngjes hap sytë e shoh muret. Droga më ka shkëputur nga e gjithë familja. Edhe ata që më kanë ndihmuar, janë lodhur me mua. Përveçse përdoruesve të drogës nuk kam njeri, po edhe me ata vetëm përshëndetem.” –Thotë një I drogëtar

Droga në familjen shqiptare është një plagë e rënde që duhet eliminuar. Shqipëria tashmë ka strategjinë kombëtare antitrafik në të cilën janë përcaktuar edhe drejtimet kryesore të punës për realizimin e parandalimit dhe të trafikimit të drogës. Megjithatë familja shqiptare i duhet ende një punë e madhe për të realizuar objektivat dhe angazhimet në luftën kundër drogës e trafikimit të saj.

Pasojat nga përdorimi i drogës në familje janë të rënda. Shifrat e errëta të përdoruesve janë shumë herë më të mëdha se sa rastet e regjistruara. Edhe në viset shqiptare drogat po bëhen vrasarët kryesorë të shëndetit të pjesës më vitale të popullit.

Njerëzit e varur nga drogat duhet ndihmuar në çdo formë nga familja, rrethi, shkolla, institucionet etj. për të shpëtuar nga kthetrat e egra të sëmundjes së varësisë.

Duke u bazuar në shumë studime dhe sondazheve që janë bërë, arrimë në konkluzionin se kandidatët më të rrezikuar nga ky fenomen janë të rinjtë me një bazë të brishtë familjare.

Përdorimi i drogës është një çështje shumë emocionale dhe problematike në familjen shqiptare, për të gjitha nivelet shoqërore e shtetërore. Përdorimi i drogës dhe problemet që shkaktohen nga ajo janë më të vjetra nga sa mendojmë ne, por jo rrallë thuhet se në familjen Shqiptare droga erdhi me demokracinë. I referohem fazës së demokracisë për faktin se ndryshimet në kulturë, në vlerat e lëna pas, por dhe të fituara, në mënyrat e të sjellurit që u moderuar ose kërkohen të bëhen të reja për këtë sistem ekonomiko-shoqëror, u shoqëruan edhe me trauma sociale si dukuria e përdorimit të drogës nga të rinjtë. Ky kalim duhej menaxhuar me qëllim që të kishim sa më pak pasoja negative.

Tranzicioni dhe dukuria e përdorimit të drogës në Shqipëri, ndryshimet e mësipërme kulturore, mos përgatitja për ta parandaluar atë e fuqizuan këtë dukuri, që në ditët e sotme nuk është vetëm shqiptare. Cilët janë faktorët që çojnë në rritjen e nivelit të përdorimit të drogës dhe mbi të gjitha në abuzimin me të? Ekzistojnë disa faktorë që në tërësinë e tyre çojnë në rritjen e nivelit të përdorimit të drogës dhe mbi të gjitha në abuzimin me të.

1-Statusi social-ekonomik i familjes.

2- Problemet e personalitetit. Shumë teori pranojnë se individë të veçantë përdorin drogë sepse kanë nivel të ulët të vetëvlerësimit, depresion ose ankth. Vetëvlerësimi në dukje e ndihmon lidhjen me drogën, pasi shpesh përdorimi në grup i drogës nxjerr në pah vlerësimin e grupit duke anashkaluar atë individual.

3- Papajtueshmëria me gjendjen është një faktor tjetër që çon në përdorimin e drogës nga individ. Këta individë të papajtueshëm shpesh kanë marrëdhënie më të ngushta me bashkëmoshatarët e grupit sesa me prindërit e tyre. Duke i shtuar këtij faktori edhe dukuri të tilla si mungesa e njërit prej prindërve në familje si rezultat i problemeve të ndryshme që ekzistojnë në familjet shqiptare.

shoqërinë shqiptare, për sot dhe për të ardhmen e saj. Duhet thënë se problemi është i pranishëm më shumë në zonat e mëdha urbanë është më i madh të meshkujt se sa tek femrat.

Tashmë fatkeqësisht familja Shqiptare e papërgatitur për tu përballur me këtë fenomen po lëngoj nga pasojat kultivimit, tregtimit dhe përdorimit të saj.

-Droga po e çon familjen drejtë fundit.

Kur zbulojmë se më të dashurit janë të varur nga droga, së pari vjen shoku, mosbesimi, pastaj mërzia, shqetësimi dhe dëshpërimi.

Këto janë tronditje shumë të mëdha që kanë ndikim të madh në familje. Deri dje ishte fëmijë i mirë, partner i mirë, prind i mirë, dhe pastaj situata ndryshon brenda natës. Droga me të vërtetë mund të shpie

jëson veten duke menduar që ka gabuar diku.

Droga ndryshon trurin e personit të varur

Nuk është faji i familjes nëse një anëtar i saj ka filluar të drogohet. Ai është një vendim i keq i atij, i cili e shpie drejtë shkatërrimit edhe atë edhe familjeve. Megjithatë nuk është krejt ashtu bardhë e zi.

Droga sjell ndryshime të proceseve kimike në tru të cilët ndikojnë në mendimet, emocionet dhe sjelljet e njerëzve. Ata më pas bien në rreth vicioz të drogës në të cilin sillen dhe nuk shohin rrugëdalje nga aty. Jo rrallëherë vjedhin para dhe i futen punëve ilegale vetëm për të ardhur tek paratë, të cilat i ofrojnë një “moment të shkurtër lavdie” dhe një varg pasojash negative.

Kur ndodh ndonjë konflikt debate të ashpra me personin e varur, mos harroni që ato nuk janë vetitë e tij, por pasojat e varësisë, dhe për këtë arsye fajësoni drogën sepse ajo është armiku i përbashkët i vërtetë, të cilit mund t’i prihet rruqa.

Familja shqiptare e rrezikuar nga Droga që në hapat e para të krijimit të saj e në vazhdim.

-Adoleshentet po e përdorin drogën, ata në të ardhmen do kërkojnë të krijojnë familje. Përdorimi i drogës e zbe dhe dëmton shumë të ardhmen e tyre si prindër. Edhe në qofte së arrijnë të ngjizet një fëmijë ai në kraharorin e një nëne që abuzon me drogën do haste në shumë problem me zhvillimin si fetus. Droga që gruaja shtatzënë përdor, përçohet nëpërmjet qarkullimit të gjakut në placentë dhe në fetus nëpërmjet litarthit të kërthizës. Fëmija në barkun e nënës (Fetusi) Organet e fetusit në barkun

e nënës, nuk janë plotësisht të formuara për të shpërberë droge, prandaj ndikimi i drogës është më i madh tek fëmija sesa tek nëna vetë. Fetusi është në rrezik gjatë gjithë shtatzënisë, por shkalla e dëmtimit varet nga faza e zhvillimit të trurit të fetusit. Zhvillimi i organeve të fetusit në barkun e nënës nuk është i njëjtë në fazat e ndryshme të shtatzënisë. Organet në vetvete janë më të ndjeshëm duke pasur parasysh fazën e zhvillimit të shpejtë të tyre. Dihet se, një përdorim i tepruar i drogës në shtatzëni mund të shkaktojë dëmtime serioze tek fetusit në bark, p.sh kjo mund të rezultojë në defekte lindjeje të dukshme në fytyrë, koka mund të jetë më e vogël se masa normale apo mund të shfaqen defekte në zemër si dhe në gjymtyrë. Rrezikshmëria mund të shkojë deri në humbjen e fëmijës. Droga; kanabis sativa, ekstasi, amfetamina dhe kokaina, mund të shkaktojnë humbjen e jetës së fetusit në bark, dëmtimin e placentës ose një lindje të parakohshme të fëmijës.

Ka rrezik që zhvillimi normal



Ekzistenca e këtyre faktorëve në tërësi, gjatë tranzicionit të familjes shqiptare, krijon parakushte social-ekonomike për individët, veçanërisht në radhët e adoleshentëve, për përdorimin e drogës. Këtij faktori i shtohet fakti i kërkesës që rrjete të trafikimit ndërkombëtar të saj kanë për vendet e varfëria si Shqipëria, në statusin e tregut të shitjes për përdorues ose si vende tranzite për trafikimin e saj drejt vendeve të zhvilluara. Shqipëria si vend i varfër, kushtëzon cilësinë e ulët të drogës që përdoret përkundërt fuqisë blerëse të ulët të përdoruesve dhe si e tillë kjo është edhe më vdekjeprurëse për përdoruesit dhe ata që abuzojnë me të.

Rritja e niveleve të përdorimit, e abuzimit me drogën gjatë këtyre viteve flet për programe dhe politika të paqarta të parandalimit të këtij fenomeni nëpërmjet edukimit të të gjithë shoqërisë, pavarësisht nga efektet si prekshmëri individuale ose në nivel familje.

Droga është nga ato rreziqe sociale që efektet negative të saj i mbart për gjithë

njerëzit drejtë fundit, por jo vetëm ata, gjithnjë bëhet fjalë edhe për familjet e tyre që dalëngadalë fundosen me ata.

Droga shkatërron marrëdhëniet familjare

Personi i varur nga droga nuk mund të fsheh problemin e tij përgjithmonë. Kur të zbulojnë atë të dashurit e tij, vjen deri tek shkatërrimi i marrëdhënieve familjare.

Personi i varur zakonisht reagon me frazën “thjeshtë e kam provuar, nuk do të përsëritet”, por kjo kurrë nuk ndodh në praktikë. Personat e varur nuk janë të vetëdijshëm sa kanë “hyrë brenda” dhe mashtrojnë veten dhe të tjerët që gjërat janë nën kontroll, e në të vërtetë janë larg saj. Kur familja i kap ata për herë të dytë, vjen deri tek zhgënjimi dhe humbja e besimit.

Besimi është si pasqyra, kur thyhet një herë kurrë më nuk do të jetë e njëjta. Për këtë personat e varur nuk janë të vetëdijshëm dhe prapë lëndojnë më të dashurit e tyre.

Në këto raste familja e pikëlluar fa-

LUFTA KUNDËR PËRDORIMIT TË LËNDËVE NARKOTIKE, EFEKTET SHOQËRORE DHE MJEKËSORE KUNDËR KËSAJ TË QUAJTUR “VDEKJE E BARDHE”. NËN MOTIVIN “TI MERR DROGË DHE AJO TË MERR JETËN”

Sot lufta kundër gjithë llojeve të drogave qoftë legale ose të paligjshme është një problem madhor kudo në botë por këtë 20 vitet e fundit dhe për vendin tonë; jo vetëm për kultivimin e marjuanes, kanabisit, përdorim i alkooleve, duhanit por ka filluar përdorimi i formave të ndryshme të drogave në kombinim si: alkool + hashash, narkotike të ndryshme që nga morfina, heroina, valium e gjinitë e tij. Pra është një problem madhor jo vetëm i shëndetit publik, por edhe për gjithë shoqërinë.

Nuk ka ditë ku në kronikën e zezë, zënë shumë vend në Evropë dhe përtej Atlantikut të kombinuar me persona e grupe të rinjsh të moshës 18-40 vjeç që marrin pjesë në krimet e këtij trafiku. Jo vetëm meshkuj por dhe femra. Siç dihet droge, lëndë narkotike është çdo substance që kur merret me çfarë do rruge, me tymosje, me pije ose me injeksion ndryshon aktivitetin e trupit të individit. Me kalimin e kohës personat që përdorin atë bëhen të varur. Pra, ai e ndjenë të domosdoshme ta marrin këtë lende, e cila fillon që nga kafeja, alkooli dhe shumë më e theksuar me kanabisin, hashashin e deri tek heroina dhe kokaina. Pra, varësia psikologjike përfshin ndjenjën e kënaqësisë dhe dëshirës për ta përsëritur këtë eksperiencë pa rezistuar më pa të.

Varësia fizike shfaqet me mos durimin pa të, pra ka tërheqje saqë po ta ndalojë marrjen e saj ndihet i shqetësuar, mbyllet në vetvete, pa humor dhe pa i fuqishëm.

Nuk vonon shumë dhe zhvillohet e ashtu quajtur tolerance ndaj kësaj lënde duke pasur nevojë jo vetëm për ta marrë atë por edhe me doza me të larta për ta arritur efektin e dëshiruar, krijohet kështu tërheqja ku përballet mes shenjave të

pakëndshme dhe madje të rrezikshme si shterngim muskujsh, prishje humori, ankth, djerse, zbehje, të vjella gjë që është më e theksuar kur ndërpritet menjëherë marrja e saj ose kur merret në doza të vogla.

Këto simptoma të tërheqjes fillojnë pak ore mbas marrjes se dozës se fundit dhe vazhdojnë e shtohet për disa dite radhazi. Kështu marrja e tepruar shkakton varësi apo dëmtime të tjera të pa rikthyeshme të trurit, zemrës dhe organeve tjera vitale. P.sh kokaina është e prire të jap atak zemre vdekjeprurës.

Përdoruesi i drogës përkeqëson performancë në punë, në shkollë dhe në veprimtari të tjera, nuk është në gjendje të ketë mendime të qarta as nuk mund të marre vendime, ato mund të përfshihen në ngjarje të rrezikshme, që dëmtojnë veten si vetëvrasje ose konflikte me të tjerët deri me njerëzit më të afërt për të realizuar dëshirat e veta.

Sipas të dhënave, në vitin 2010 numri i përdoruesve të lendeve të paligjshme është llogaritur 40 000-60 000 vete, ku mendohet se 10-15 % e tyre përdorin doza me injektim venoz. Që në vitin 1995 të rriturit 15-64 vjeç kishin provuar droge të paligjshme afër 5000 vete, dhe në 1998 ky numër raportohej 20 000 pra një rritje katërfish.

Ky fenomen, sipas të dhënave të ISHP është më tepër problem urban. Pra, në qytetet më të mëdha të vendit si Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër e të tjera, se sa ato rurale. Por problem i mbjelljes së kanabisit, marjuanes është bere problem serioz vitet e fundit në zonën e veriut ku më pare ishte në Lazarat.

Një studim i ISHP, në vitin 2009 që përfshinte shkollat e mesme duke marre

në interviste një kampion prej 3873 vete shprehet se adoleshente 15-18 vjeç kanë provuar kanabis 7.4%, ekstazë 4.2%, heroine 1.2% dhe kokaine 3.2%, sidoqoftë nuk kemi një numër të sakte të përdoruesve.

Kanabisi përmban afro 400 lëndë në përbërjen e vet. Ajo përdoret me cigare, gjethet e tij dhe lulet e marjuanes, që përmbajnë 0.5-1 gr lende aktive.

Methamfetamina (kristal) përdoret nga të rinj për tu ndjerë mirë në eufori, e cila me vonë shfaqet me dhimbje koke, rrahje zemre, turbullime gjumi etj, po kështu përdoret dhe LSD (diethyl amidi i acidit lisergjik) e cila është një lende shume e forte ku me 20 mcg mund të ketë efekte fiziologjike dhe psikologjike, me rritje të ritmit të zemrës, rritje të TA-se duke modifikuar humorin në mënyre ekstreme mbas 30 min.

Pasojat shëndetësore përveç efekteve të menjëhershme mbi psikikën si toksikomania pra siç u shpreh me lart ka dhe efekte fizike familjarizim, sëmundje mendore e të tjera, që mund të çojnë në përfundim të keq, me vdekje nga mbidozimi, koma, varësi krahasuar me ato që nuk e përdorin.

Nuk duhet lenë pa përmendur disa statistika marramane dhe për drogat e ligjshme si alkool, duhan ku tek ne nuk funksionon sa ligji anti duhan ku vazhdohet te pihet ne çdo ambient publik ashtu edhe ne institucionet shëndetësore.

Sipas të dhënave, Franca raporton 60 000 vdekje në vit nga duhani, 4 milion vete vdesin çdo vit në shkalle botërore. Pra, në çdo 8 sek një vdekje.

Alkooli provokon 750 000 vdekje në çdo vit. Në France 45 000 vdekje. Sipas të dhënave të Anglisë, në vitin 1998, 11%

e adoleshenteve 16-17 vjeç ishin ndaluar një here për përdorim opiumi. Sipas OBSH 1.5% e moshës 16-20 vjeç kane provuar të marrin opium.

Disa mendime për strategjinë e kësaj lufte në rrethin tone:

*Strategjia duhet të jetë gjithëpërfshirëse nga të gjitha institucionet ligjzbatuese nga shkollat, institucionet shëndetësore, duke rritur propagandën qoftë me anën e shtypit, veprimtarive në shkollat e të tjera, për të njohur mire problemin.

*Në çdo shkolle, jo vetëm në qytet por edhe në rrethina duhet të ketë një psikolog për të trajtuar çështjet sipas një metodologjie të veçantë.

*Të ketë qendra publike të specializuara siç e ka Tirana dhe në rrethin tone për trajtimin dhe detoksifikimin, duke regjistruar rastet dhe duke i trajtuar Metadon si zëvendësues afatgjatë i drogës.

*Të ndërgjegjësohen edhe familjarët e përdoruesve, të cilët duhet të regjistrojnë personat për të marre mjekimin e duhur dhe të hiqet një here e mirë tutela e turpit, pasi tani e dine të gjithë njerëzit për rastet konkrete.

*Individet përdorues duhet të kenë mbështetje të veçantë dhe të evidentohen e të marrin mjekimin e duhur.

*Pranë ambienteve të shkollave të vendosen fletëpalosje në lufte kundër përdorimit të lëndëve narkotike dhe të shoqërohet me shfaqje konkrete të rasteve. Programe parandalimi duke trajnuar mësuesit për praktiken e menaxhimit dhe të shpërblehen nxënësit me sjellje shembullor dhe të shtrohet një diskutim midis bashkëmoshatareve për çështje që i shqetësojnë ato.

Dr. Med. **NDUE NIKAJ**,
Shkodër, me 29 shkurt 2020

◀ mendor i fëmijës të dëmtohet.

- Drogat janë ato lëndë që me sasi të disa miligramëve çrregullojnë dhe destabilizojnë funksionet mendore, zvogëlojnë vigjilencën, çojnë në rritje progresive të dozave dhe shkaktojnë varësi pas një përdorimi disa ditë ose javor. Përdorimi i vazhdueshëm i tyre bën që të ulet veprimtaria e trurit dhe të prishet ekuilibri i sistemit mendor, gjë që largon personin nga jeta dhe veprimtaria e përditshme shoqërore dhe familjare. Në këtë rast mund të shfaqen sëmundje mendore si psikopatia, humbja e shpejtë e vetëdijes, pagjumësia, halucinacionet, humbja e kujtesës dhe shumë efekte tjera të dëmshme.

- Sot në shkollat tona, trafikantët e drogave ndërtojnë rrjetet e manipulimit për të futur dhe shitur drogën. Këtu familja është dy herë e rrezikuar. Sepse ajo e nisë fëmijën për në shkollë e aty ai bie në kurthin e këtyre rrjeteve. Adoleshenti behët përdorues i drogës dhe disa prej tyre në të ardhmen kthehen në karrema për tu afruar drogën shokëve dhe shoqeve. Dhe ky është hapi I parë në përfshirjen e rrjeteve të ndryshme.

- Të marrësh drogë duhet ta blesh,

duhen lek, deri diku në fillim këto lek merren nga familja pastaj, kur dozat fillojnë të rriten përdoruesit e saj janë të detyruar që lekët e drogës ti marrin në të gjitha format, duke vjelle sendet e familjes, duke marr borxh, duke mashtruar etj. Familja në këto raste përballet edhe me problemet ekonomike të cilat e vështirësojnë jetën e saj e në veçanti jetën e personit të droguar. Në këto raste familja mundohet të ndjek rrugët me të shpejta për të shpëtuar anëtarin e saj. Ju drejtohen spitaleve dhe organizativë të ndryshe e mundësit e shpëtimit janë edhe nuk janë. Në shumë raste kur bashkëpunimi dhe menaxhimi i mirë i këtyre rasteve çon në rezultate pozitive. Por në shumë raste, kur mungon një hallkë e bashkëpunimit rezultatet janë fatale.

- Familja shqiptare e ndodhur para këtij fenomeni e papërgatitur krahas shkaqeve të lartpërmendur në shumë zona po vuan dhe shkaqet e përfshirjes së një anëtarit ose edhe më shumë në kultivimin dhe tregtimin e drogës. Kjo ka sjell shumë problematika të rënda për familjen dhe shoqërinë.

- Për tu kultivuar dhe tregtuar droga jo gjithmonë ka shkuar siç duhet, kjo si pasojë e korrjes nga drogës nga polica

ose dhe mos marrja e prodhimit të pritur ka çuar në dështimin e plotë të këtyre anëtareve. Pasi ata kanë future në këtë aktivitet para që kanë pasur, e duke qene se kostoja e kultivimit të drogës është shumë e madhe ata janë detyruar edhe të marrin borxhe.

- Në disa raste të tjera kultivimi i drogës dhe tregtimi i saj ka sjell me vetë shumë prishje pazareve dhe si pasoj kanë lindur konfliktet mes kultivuesve dhe tregtuesve. Këto konflikte në disa raste kanë përfunduar fatkeqësisht në konflikte me arme ku ka pasur dhe të vdekur dhe kështu e gjithë familja vuan pasojat.

- Krijimi i rrjeteve të trafikut të drogave kanë sjell shumë konflikte mes grupeve rivale.

Shumë nga personat që kanë kultivuar dhe tregtuar drogën kanë përfunduar në burgje dhe sot familje rend sa na një gjyq në tjetrin. Sa në një burg në tjetrin. Në vend që një baba të punonte dhe të mbante familjen, sot bashkëshortja edhe familja janë të detyruar të paguajnë borxhet, gjykatat, dhe ti mbajnë nëpër burgje.

- Përfitim nga të ardhurat e drogës ka sjellë në shoqëri shumë disnivele e në shumë raste familja është dëmtuar nga ajo

fëmijë që tashmë nga droga ka të ardhura të mëdha dhe ajo nuk pyet kur sa “është çmimi...”.

Kur flasim për trajtimet, rëndësi të veçantë kanë edhe metodat parandaluese të këtij fenomeni, të cilat mund të kenë ndikim të madh në zvogëlimin dhe parandalimin e përdorimit të drogës, sidomos nga të rinjtë. Është më se e nevojshme të organizohen programe të ndryshme nga ana e policisë ose organet e tjera përgjegjëse për t'i informuar të rinjtë mbi rreziqet dhe efektet negative që kanë substancat narkotike. Një ndikim mjaft të madh ka edhe prania e psikologëve në shkollat, gjë që në shumicën e komunave dhe në shkollat përkatëse mungon. Mirëpo ajo që luan rol të madh, janë edhe këshillat e familjes dhe rrethi shoqëror me të cilët të rinjtë kalojnë kohën më shumë. Me zbutjen e këtij fenomeni shumë probleme shoqërore do të evidentoheshin, e me këtë edhe të rinjtë do të kuptonin se përdorimi i drogës nuk sjell asgjë të dobishme, veçse efekte të dëmshme që mund të ndikojnë në prishjen e stabilitetit të jetës.

Roza PJETRI,
Shkodër, me 29 shkurt 2020

RRITJA EKONOMIKE SOCIALE E KULTURORE, MUNDËSIA KRYESORE PËR ULJEN DHE LARGIMI NGA KRIMINALITETIT

Në çdo kohë ka pasur dhe ka krime të formave dhe përmasave të ndryshme, të cilat kanë kurbat e ulje ngritjes së tyre, në përhapje, në llojshmëri, edhe me pasoja negative. Me keqardhje e them se vitet e fundit kurba e kriminalitetit në krahinën e Dukagjinit ka ngritje, gjë që ka çuar edhe në konflikte, ngatrra, të cilat kanë qenë shkak edhe për konflikte fatale, siç janë krimi kundër



përsonit, prodhimi dhe përhapja e bimëve narkotike, armëmbajtja pa leje, të cilat e bëjnë jetën e komunitetit të vështirë, humbë besimi për punë, humbë perspektiva, krijon një amull që nuk sjellë asgjë pozitive, por vetëm negativitet, depression, neuroza, të cilat çojnë veprime emocionale e impulsive.

Dëgjojmë në media të ndryshme se Dukagjini është prodhues i madh, mbase kampion thuhet ndonjë herë, i prodhim-it të drogës. Nuk them se nuk ka prodhim të kësaj bime dhe sigurisht bëhen përpjekje për ta futur në treg, sepse për atë qëllim prodhohet, por që të jenë kampion nuk e mendoj një gjë të tilla. Nuk kam dhe nuk kam parë ndonjë statistikë zyrtare, dhe krahasime me zona apo krahina të tjera, por një gjë duhet analizuar dhe studiuar, e cila ka të bëjë me klimën e fortë malore, sipërfaqen jo të madhe ku mund të kultivohet, në krahasim me sipërfaqen e përgjithshme të kësaj krahine, kushtet klimatike jo të favorshme për zhvillim, vështirësi në mundësinë e ujitjes, plehërimit e përpunimit në kohën e duhur, shpërndarja në terriore të hapta dhe të vështira për ti shërbyer, etj. të cilat nuk favorizojnë të qenët aq prodhues, apo kampion. Sidoqoftë, sipas statistikave që dëgjojmë në media, ka prodhim, dhe për ndalimin e tij duhet të punojmë të gjithë, pasi është burim i kundërligjshëm dhe individualisht e shoqërisht i dëmshëm.

Dukagjini është krahinë, nga më maloret në Shqipëri. Ka një sipërfaqe prej 607. 59 km², shumica dërmuse e të cilës nuk mund të vihet nën kulturë.

Dukagjini, në vitin 1990, kishte katër zona me 42 fshatra dhe 18100 banorë. Sot zonat Shalë, Shosh dhe Pult përfshihen në Bashkinë Shkodër, ndërsa Shllaku, i ndarë në dy njësi administrative është i përfshirë në Bashkinë Vau i Dejës.

Dukagjini ka klimë me alternime të dukshme në periudhën verë-dimër. Vera është e freskët, por ka mjaftë raste që në pjesë të saj të jenë mjaftë nxehtë. Dimri është i ftohtë, me borë e ngrica. Në datën 10 janar 2017, në orën 09.00, sipas të dhënave satelitore, temperatura në Theth ka qenë -24°C, e për shkak të lagështirës konceptohej -26°C.

Dukagjini ka një botë bimore dhe shtazore shumë të pasur. Në këtë territor ndodhen rreth 50% të llojshmërisë së botës bimore të Shqipërisë.

Por, Dukagjini është edhe nga krahinat më të vonuara të zhvillimit në tërësinë e tij, për vetë kushtet natyrore, mos kujdesit të qeverive qendrore dhe vendore, mos kujdesit për shfrytëzimin e mundësive natyrore, si pyjeve,

kullotave, larmisë së bimësisë mjekësore, bimëve të egëra të ngrënshme, të cilat nuk janë të pakta, bimëve ngjyuese, duke përfshirë këtu edhe botën e kafshëve të egra, të shumëllojshme dhe interesante. Pa diskutim që të gjitha këto kanë një mundësi shfrytëzime të përcaktuar me ligjë, i cili duhet zbatuar me përpikmëri, sepse nuk kemi të drejt të jetojmë, e të shfrytëzojmë vetëm për veten tonë, por duhet tu lëmë edhe brezave të ardhshëm që të jetojnë normalisht. Ky është zhvillimi i qendrueshëm, pra të jetojmë vetë, por gjithnjë të mendojmë për brezat që vinë. Tokën na e kanë lënë të parët, në përdorim, për tua lënë brezave që vinë.

Marrëdhëniet shoqërore në mjedisin dukagjinat tradicionalisht janë ruajtur dhe vazhdojnë të ruhen edhe sot, dhe të arrijë që një barishte të na përziej, të na trudhosë, të na prishë marrëdhëniet e mira që kanë qënë, dhe që duhet të jenë. Ne kemi nevojë për tu afruar njeri tjetrit në të mirë të secilit dhe të të gjithëve. Qenia afër njëri tjetrit, vëllazërisht, me mendje e zemër, na bën më të fuqishëm, më përparimtar, më të zhvilluar edhe mendërisht edhe ekonomikisht. Impulsiviteti, apo emocionet e çastit sjellin pasoja të pa riparueshme, për të cilat edhe pendohen në mos brenda oresh, brenda ditës, por akti është kryer. Nuk duhet të harrojmë fjalën e urtë popullore që përdoret në Dukagjin: "Idhnimin e nadjes lere për në mbarëmjë dhe idhnimin e mbrëmjes lere për në nadje", sepse për pak i biri desh vrau babën se ishte kthyer nga mërgimi i atëhershëm (po komunikimin e sotshëm) në shtëpi në mbrëmje vonë dhe kishte ra në shtrat me të shoqen. Djali, tashmë i rritur, duke menduar se ishte ndokush tjetër mendoj ta vriste, por në momentin e fundit ju kujtua ajo fjala që përmenda pak më parë, dhe e la që të sqarohej në mëngjes dhe mirë bëri, ose "burri i urtë kurr nuk ngutet prej trimnie e jo prej tute". Trajtimi i problemeve qetësisht, pa gjaknxehtësi, pa emocione, pa impulsivitet, natyrisht, qartësisht, çon në zgjidhjen e tyre, përmirësimin e marrëdhënieve shoqërore dhe në pajtimin me ligjin. Kjo çon në zgjidhjen e problemeve personale dhe shoqërore. Në Dukagjin dhe kudo ku

jetojnë ata, janë njerëz të mirë, të zgjuar, burra e gra, të rinjë e të reja, me të cilët mund të bisedohet e punohet, dhe ti hapet rrugë zhvillimit normal të krahinës të largohen nga veprimtaria kriminale që duket sikur është frutdhënëse, por që koha ka vertetur krejt të kundërtën.

Faktori kryesor për largimin nga kriminaliteti është rritja e nivelit ekonomike. Nevojat ekonomike dhe puna për ngritjen e mirëqenies, nxitë edhe një farë ambicjeje, një farë konkurrence, kur e ka ai pse të mos e kem edhe unë, etj. sepse, një thënie popullore thotë, "shesh rrusi rrushin e piqet". Zhvillimi i krahinës është pengesë e përhapjes së elementëve kriminal, si bimëve narkotike, por edhe krimeve të tjera, të cilat çojnë në pasoja të rënda personale, familjarë dhe shoqërore. Kushtet e vështira të jetesës të shtyjën drejt ekstrimit, ti errësojnë sytë, ta bllokojnë trurin, e mbytë arsyen dhe i len vendin instiktit, sepse mjerimi është kafshatë që s'kapërdihet, shkruante Migjeni. Të parët tonë kanë bere jetën si "bishë malit" siç shkruante At Gjergj Fishta, dhe e kanë pranuar atë jetesë për të qenë të lirë, sepse as nuk kishte kujt ti ankohej, të kërkonte ndihmë sepse nuk kishte shtet që të kujdesej. Sot kanë ndryshuar kushtet, janë rritur kërkesat, është zgjeruar horizonti, edhe dukagjinat kanë parë botë me sy. Në këso momentesh "gjuha" shkon aty ku dhëm dhëmbi, te nevojat ekonomike, kushtet e jetesës, komoditeti, paisjet dhe orenditë shtëpiake, pra mirëqenia ekonomiko-kulturore. E parë në këtë këndvështrim, është shumë e rëndësishme kthimi i vështrimit në drejtim të kësaj krahine, sepse është një mundësi, madje mendoj se është kryesorja për të ulur dhe zhdukur kriminalitetin, e veçanarisht, prodhimin dhe shpërndarjen e narkotikëve.

Ekonomia e ardhur pa punë, pa djersë nuk ka pasur dhe nuk ka themele të qëndrueshme, thjeshtë, nuk është e mirë.

Në përparimin dhe zhvillimin e një vendi, pa tjetër, është ngritja e nivelit arsimor dhe kulturor të popullatës. Vërtetë pjesa më madhe e Dukagjinit është larguar nga vendlindja për një jetë më të mirë. Por kjo nuk duhet të thotë se tash mund të bëhet gjithçka për tu pasuruar me shpejtësi dhe në mënyrë të pa kontrolluar dhe me fjalën kontroll nuk e kam aspak nga ato që kryejnë organet ligjë zbatuese, por së pari vetëkontrolli, pra, të bëhen veprime të mirëmenduara, duke analizuar dhe parashikuar të ardhmen e afërt por edhe perspektivën. Shkollimi, ngritja e nivelit kulturor të komunitetit, janë me-nyra nga më të mirat për një zhvillim të qëndrueshëm të krahinës. Në këtë drejtin rol shumë të rëndësishëm ka familja dhe shkolla në edukimin e fëmijëve, por është shumë e vështirë po të mos ndihmojnë shteti me punë dhe mjete në shërbim të mësimit dhe edukimit. Lidhja e shkollës

më familjen është domosdoshmëri, gjithmonë dhe në çdo drejtim për edukimin e brezave. Roli i religjionit fetar është i pazëvendësueshëm në gjithë jetën e një komuniteti, dhe për pasoj edhe në luftën kundër veprimeve kriminale për minimizimin dhe largimin prej tyre.

Kujdesi për shkollën dhe shkollimin, trajnimi me përgjegjësi të lartë shkencore, metodike dhe morale i mësuesve, lidhjet me komunitetin, forcimi i bashkëpunimit edhe me masën e nxënësve, për ti bindur ata, për ti bërë të ndërgjegjshëm, dhe jo për ti frikësuar, janë domosdoshmëri në uljen e kriminalitetit, sepse në të ardhmen e afërt këta nxënës do të dalin në jetë e do të jenë pjesë aktive e komunitetit.

Por për të rritur të ardhurat janë faktor edhe infrastruktura, turizmi, sporti, veprimtaritë kulturore-artistike, ecjet malore, alpinizmi, të cilat çojnë drejt minimizimit të veprimtarive kriminale, për shumë arsye.

Dukagjini, është një krahinë me shumë vlera. I gjithë territori i Dukagjinit është një vend shumë interesant turizmi. Me vlerat e tij natyrore, historike, etnografike, me njerzit e tij të mirë, me gojtarinë e tyre të rrjedhshme, me këngët e veglat muzikore, me toponimet, me burimet ujore shumë të pastra, me florën dhe faunën shumë të pasur, me bimët mjekësore të shumëllojta, etj. janë mundësi zhvillimi e përparimi të papërsëritshme. Prandaj është e mundur dhe po të duam të largojmë elementët kriminal, ti vëmë në shërbimin tonë. Këtu punësohen shumë njerëz, rriten të ardhurat dhe mirëqenia e popullsisë, dhe edhe gjumi bëhet rehat. Por Dukagjini, do edhe infrastrukturë rrugore, uji të pishëm në çdo familje, energjia elektrike, shërbimi shëndetësor, rrjeti shkollor me nivel më të lartë, mbrojtja dhe menaxhimi i resurseve natyrore, si pyjeve, kullotave, bimëve mjekësore, objekteve natyrore si shpellat, lumenjtë, burimet. Të gjitha këto kërkojnë mbështetje të organizuar, trajnime, përmirësim në menaxhim e kulturë shërbimi dhe pa tjetër do të rriten të ardhurat. Kjo nuk mund të bëhet po organizimin dhe mbështetjen e shtetit, pa koordinimin e tij, pa mbështetjen e njerzëve që mund dhe duhet të merren me këtë punë.

Dukagjini është vend turizmi, është vend pune e përparimi, e për asnjë rast nuk e mendoj të jenë vend kanabisi e kriminaliteti.

Është dhe duhet për tu përshëndetur me respekt policia e shtetit, për punën e saj, e cila kryhen detyra të vështira dhe me sakrificë e rrezikshmëri të madhe, por policia duhet mbështetur dhe ndihmuar sepse është për të mirën e komunitetit mbi bazën ligjore.

Mjedisi me elementë kriminal ndikon shumë në formimin e fëmijëve dhe brezit të ri. Brezi i sotëm i rritur duhet tua

pastrojmë rrugën dhe mjedisin ku jetojnë. Duhet të punojmë frontalisht, të gjithë, që të rritim fëmijë në mjedise të pastra nga bota kriminale në qoftë se i duam ata, në qoftë se duam atdheun, vendlindjen që aq shumë e trumbetojmë në tubime e diskutime të ndryshme.

Media vizive, duhet të jenë më e kujdesshme, sepse në vend që të edukojë, pa dashje bëhet një farë trajnimi me lajme e pamje të vështira edhe për të rriturit, me informacionet që jep deri në detaje se si janë kryer veprimet kriminale, etj. Kjo ndodhë edhe nga nxitimi për të dhënë informacionin sa më parë. Prej kohësh, që kur kam qenë fëmijë, kam dëgjuar një tregim popullor që bënte fjalë se si një shërbëtor i një zotërie, që ishte në moshë të vogël, por edhe trup vogël, mësoj se si t'i vidhte mollat zotrisë. Ai kishte futur një sasi mollash në një fuçi të madhe, që tek ne quhet tinar, i cili mund të ishte deri në 10 kv. Thirri shërbëtorin dhe po e akuzonte se i kishte ngrënë mollat që i kishte hellur aty. Djali duket se nuk i kishte marrë mollat, dhe përgjigjej i sigurtë se nuk dinte asgjë për këtë punë. Përfundimisht zotëria i thotë shërbëtorit se ti mi ke marrë. Po si mendon se ti kam marrë, kur jam kaq i vogël dhe nuk mund të hypi atje, dhe po të bie brenda mbetem aty. Jo i thotë zotëria, ti merr një shkop të gjatë e mprehë në majë dhe pasi hyp në diçka e futë shkopin në tinar dhe e ngullë në molla, dhe kështu e nxjerrë nga tinar. Në këtë mënyrë ai fëmijë mësoj metodën të cilën nuk e dinte se si mund ti merrte mollat. Edhe publikimet e panevojshme, nganjëherë, në vend që të vejnë vetullat rrezikojnë, apo nxjerrin sytë. Hollësira e stërhollimet u takojnë organeve ligjzbatuese. Për të tjerët ka informacion që mund të thuhet për të gjithë.

Në asnjë mënyrë dhe për asnjë moment nuk bëj dhe nuk duhet të bëjmë justifikimin e shfaqjeve të kriminalitetit për asnjë. Ne duhet të hulumtojmë se cila është mundësia që i shtynë njerzit drejt këti fenomeni. Duke gjykuar për zgjidhje të përhershme, konkretisht, unë mendoj mundësinë e uljes së kriminalitetit,

duke përcaktuar së pari "bregun pastaj të ngremë velat", pra të përcaktojmë synimin për tu arritur, i cili mundëson minimizimin dhe largimin nga kriminaliteti, i cili sipas meje është:

Si e mendoj unë arritjen e këtij synimi:

1. Ngritja e nivelit arsimor dhe kulturor të komunitetit nepërmes shkollimit më të mirë, më cilësor, nëpërmes shkollimit më të mirë, kualifikimeve, trajnimeve, shkëmbimit reciprok të përvojës, binjakëzimeve me shkolla me emër në qytete apo zona të tjera, të cilat kanë përvojë për të përfituar prej tyre.

2. Vënia në shfrytëzim nga shteti dhe komuniteti i rezervave të shumta natyrore që ka kjo krahinë, më së pari në shërbim të komunitetit të krahinës duke punësuar njerëz në maksimumin e mundshëm.

3. Të shpallet gjitha krahina e Dukagjinit "Zonë Turistike", të bëhen guida për të gjithë territorin, që nga Qafa e Bëshkasit, Qafa e Thanës, Shkalla Logjë, Bregu i Drinit, Cukali, Park-Blini në deltën e Lumit të Shalës, Toplana, Qafa e Agrit, Qafa e Ndërmajnës, Rrjedha e sipërme e Valbonës, Fusha e Gjësë, Jezerca, Liqenet e Jezercës, dhe gjithë territori brenda këtyre pikave. Guidat duhet të përfshijën të gjitha fshatrat.

4. Lidhja me shoqata, veçanërisht atyre mjedisore dhe turistike dhe tërheqja e tyre për të investuar dhe bërë projekte, trajnime e kualifikime me grupe të veçanta të komunitetit, për të rritur mundësinë e shërbimit më të kualifikuar në pritjen e përcjedhjen e vizitorëve.

5. Zhvillim, trajnimesh e kalifikime me mësuesit që punojnë në këtë krahinë, për të ngritur nivelin e tyre për punën në shkollë dhe jashtë saj, duke qenë se janë pjesa më e arsimuar dhe pishtarë të arsimit dhe kulturës në këtë territor.

6. Trajnime dhe veprimtari praktike për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

7. Tërheqja në veprimtari kulturore dhe sportive, ekskursione, veçanërisht brenda krahinës, me plane të mirëmenduara, të mirëmenxhuara, por dhe të mirë financu-

ara.

8. Të ftohen dhe të mundësohen veprimtari nga OJF jashtë Shqipërisë për të investuar me projekte në këtë krahinë, ndoshta sipas modelit të Projektit të Parkut Ballkanit të Paqës, në Theth, pak vite më parë, apo GIZ-it, etj.

9. Të tregohet kujdes jo vetëm me konstatime por edhe me veprime praktike dhe në bashkëpunim me Institutin e Monumenteve të Kulturës për veprat e artit dhe ato me karakter historiko-etnografik, dhe vënie e tyre në dispozicion të turistëve e vizitorëve, si dhe njohja e publikimi i vlerave të tyre.

10. Të shpallet Zonë e Lirë për një periudhë 10 vjeçare për bizneset me drejtim turizmin dhe atyre që ndikojnë direkt në rritjen ekonomike të krahinës konkretisht, mbi bazën e resurseve të saj. Së pari këtu të parashikohen dhe lehtësohen banorët dhe ish banorët Dukagjinas.

11. Të përfshihen në planet për zhvillimin e krahinës edhe dy fshatrat të cilat prej vitesh janë në administrimin e zonave të tjera siç janë Rragami i Shalës dhe Prekali, të cilat kanë të gjitha lidhjet me Dukagjinin përveç administrimit shtetëror.

12. Të përfundojë rruga automobilistike e asfaltuar Qafë e Tërthores-Prekal. Gjithashtu të futet në planet e afërta të shtetit lidhja e rrugës automobilistike Lotaj (Ura e Re)-Diga e Liqenit të Komanit, si mundësi zhvillimi, si një koridor drejt qendrës së Alpeve, duke rritur qarkullimin, e që nuk rrezikohet asnjëherë të bllokohet nga bora, por është e mundur edhe krijimi i resorteve shumë interesante turistike me punësime dhe burime të ardhurash të konsiderueshme, duke shfrytëzuar burimet hidrike për hidrocentrale me vetërrjedhje, sporte ujore, rezervuar peshku, turizëm shumë atraktiv, etj.

13. Të vihen piketime rrugësh këmbësore, të vihen pllaka përkujtimore në vende historike, të përcaktohen banesa etno-kulturore dhe mundësitë për tu vizituar, dhe të hapen shtigje për turistët.

14. Këto probleme që po përmenden këtu, nuk mund të zgjidhen me një të rënë të lapsit, nuk mund të zgjidhen brenda

ditës, prandaj e quaj të domosdoshme të ngrihet një grup pune mik, përfshirë pushtetin që nga baza deri në qendër, OJF, persona dhe grupe dashamirësish, që të mund ti analizojnë dhe të dalë me një program me afate dhe persona përgjegjës, që të përcaktojnë tri faza të zbatimit të tij, faza e parë korrente, pra të sotmen, faza e dytë afat mesme dhe faza e tretë në perspektivën e afërt, i cili tu paraqitet organeve shtetërore, OJF dhe organizmave të tjerë për tu përfshirë në të, ku secila të kryej detyrat që i ngarkohen nga programi i punës së bashkërenduar, në bazë të afateve të përcaktuara. Kjo duhet bërë, mendoj unë, në qoftë se duam që të ulim, minimizojmë, apo eliminojmë kriminalitetin, e veçanërisht drogën, të shpëtojmë një komunitet të varfër ekonomisht, por që dëshiron dhe meriton më shumë ndihmë e kujdes, më shumë të ardhura, më shumë mirëqenie e kulturë, që meriton një jetesë më të mirë.

Mundësitë e zhvillimit dhe rritja të ardhurave nga turizmi në Dukagjin janë të mëdha, edhe për faktin se shumica e territorit, me shumë vlera në të gjitha drejtimet, janë të panjohura për turistët dhe të pa shfrytëzuara. Madje kjo krahinë do të kishte një fluks të fuqishëm të turistëve. Për këtë duhet menduar edhe shoqatat që veprojnë në vendin tonë.

Në qoftë se duam të shpëtojmë një njeri, një grup, një komunitet, nuk mjafton vetëm urdhëri dhe ligji, por edhe puna edukative, mbase kjo mund të jenë e para, ngritja e nivelit të jetesës, ngritja e nivelit të kulturës në përgjithësi. Këto mundësojnë uljen të fuqishme të kriminalitetit dhe përparimin e komunitetit. Ne nuk na duhet të kemi, apo sa njerëz kemi në burg, ne na duhen njerëz, familje e krahina, e më gjerë që përparojnë që nuk përballen me ligjin dhe organet ligjzbatuese, që jetojnë në liri dhe jetë normale bashkë me pjesën tjetër të komunitetit.

Ne duhet të jemi gati të marrim përsipër detyra në këtë drejtim.

Luigj SHYTI, 29. 2. 2020

NE DUHET TË MËSOHEMI, TË BËJME DETYRËN

- Fjala e mbylljes së takimit -

Po mbyllim këtë takim pune për një problem mjaft shqetësues "Lufta që duhet të bëjmë kundër kultivimit e përdorimit të lëndëve narkotike".

Gjendja u tha në këtë takim nga ju pjesëmarrës dhe pasojat e këtij problem. Por, a duhet të dorëzohemi? Ju vete, me ligjërimet tuaja, opinionet tuaja deklaruar, se nuk duhet të dorëzohemi.

Seneca theksonte: "Para së gjithash është më e lehtë ta evitosh të keqen se sa ta trajtosh. Mos e prano, se pastaj nuk modelohet. Një here po e lejove, e keqja ulet këmbë kryq e bëhet Zot i shpirtit tënd, bëhet më e forte nga çaje ti i afte për ta shmangur, ajo nuk të lejon ta cungosh dhe as ta zvogëlosh ..."

Ne jemi, që e kemi lejuar këtë krim të vije deri në këtë nivel shqetësimi e pasojash. Pra, ne jemi, se secili nuk ka kryer detyrën e tij dhe jo vetëm kaq, por disa

janë bere dhe pjese e këtij krimi. Por, nuk është fundi, siç mendojnë disa, sepse ka forca që të dalim prej kësaj gjendje e të shmangim pasojat. Ju vete e theksuat, nëpërmjet ligjërimet tuaja. Por e theksoj e vijoj ta theksoj, se askujt të mos ja faturonjmë gjendjen e pasojat. Ne duhet të mësohemi, që qytetarët dukagjinas apo shkodrane të bëjnë detyrën e tyre ligjore, se secili duhet të bëjë përpjekje të largohet nga krim me mjaft pasoja, që secila struktura e shtetit, pushteti vendor, shkollat, policia e të tjera të bëjë detyrën e tij. Është e lehtë të thuash, se unë jam Kryeplak apo Administrator, se unë jam Kryetar Bashkie, Prefekt apo Kryetar Qarku, se unë jam Drejtor shkolle, se unë jam Drejtor policie apo punonjës policie, se unë jam baba apo nënë! Por, nuk jemi asgjë, kur nuk kryejmë detyrimet tona njerëzore e ligjore.

Këtë duhet ta themi me forcën tonë me të madhe, në qoftë se duam të dalim nga kjo gjendje dhe për të parandaluar pasojat e saj.

Shumë flasim për tradita malësore e

qytetare, për urti e burra e gra të kësaj urtie, por jo pak mbesim peng e tyre, sepse nuk jemi të emancipuar. Liria materiale e shpirtërore janë të lidhura në mënyrë të pashmangshme njëra me tjetrën. Qytetërimi presupozon njerëz të lire, sepse vetëm me njerëz të lire civilizimi, emancipimi konsiderohen të realizuar. Pra, ne dukagjinasit, ne shkodranet duhet të jemi shëmbëlltore e vlerave dukagjinase, e vlerave shkodrane, e vlerave të qytetarit të Republikës së Shqipërisë. Një nder hartuesit kryesor të kushtetutës së SHBA, Thomas Jefferson, në përfundim të saj, theksoi: "Shpresoj që URTËSIA e jonë të rritet me fuqinë tonë, dhe të na mësojë se sa më pak ta përdorim fuqinë tonë, aq më mirë do të jetë"

Në përfundim, mendoj se diçka bëmë. Me këtë takim, me këtë shqetësim që e trajtuam krimin e kultivimit e përdorimit të lëndëve narkotike dhe vlerat e mos përdorimit të tij, besoj se dhamë një mesazh të mirë. Pra, secili të kryej detyrën e tij,

në qoftë se duam të dalim prej kësaj gjendje. Ne bëmë pak nga gjithë ajo detyrë që kemi dhe besoj se e filluam mirë, me këtë ndjeje përgjegjësi.

Ju faleminderit dhe ju përhëndes të gjithëve për pjesëmarrjen tuaj, për kontributin tuaj, për mbështetjen e shqetësimit tonë, por në mënyrë të veçante për gatishmërinë e bashkëpunimit të Prefekturës, të Bashkisë, të Këshillit të Qarkut e të Drejtorisë së Policisë së Qarkut tone, Drejtorin e saj, Drejtuesit Pare, Niko Ibrahimaj. Ju faleminderit dhe here tjetër të bashkohemi për të publikuar punën e mirë, që do të bëhet në këtë fushe kundër këtij lloji krimi.

Falënderoj Prefektin, zotin Çesk Milla, drejtorin e bibliotekës, zotin Maxhid Cungu dhe avokatin Anton Kosteri, për mundësimin e përgatitjes e zhvillimit të kësaj veprimtarie.

Respekt e mirënjohje!

Ndue SANAJ,
Shkodër, më 29 shkurt 2020

PYJET, KULLOTAT DHE BIMET MJEKESORE BURIM JETESE ALTERNATIVE QË ZEVËNDËSON KULTIVIMIN E BIMËVE NARKOTIKE

Në fondin pyjor dhe kullosor të bashkisë Shkodrës, kryesisht në Njësitë Administrative të zonës malore prej vitesh është kultivuar bima tashme e njohur Kanabisit. Ndoshta këto zona e filluan këtë veprimtari kriminale me vonë se rajoni jugor i vendit, por për shume arsye sasia që filloj të prodhohej konsiderohet më e madhe se në disa zona të tjera. Në këtë fond pyjor e kullosor janë përdorur shumë çeltira për kultivimin e kanabisit, më pak ka pasur kultivim në ngastrat bujqësore. Ka pas disa arsye: së pari ka qene toka e përshtatshme, mundësia për ujitje, por dhe pamundësia për tu dalluar dhe identifikuar nga strukturat policore.

Ky është konsideruar si një "biznes" në pamje të parë fitimprurës dhe që sjell një rritje të shpejtë në ekonomi, por që në pak kohë ai jep pasoja shkatërruese për themelet ende të dobëta të ekonomisë tone. Duke filluar që nga largimi i vëmendjes nga bujqësia, shtrembërimi i tregut të punës, konfliktet sociale, kostot e kriminalizimit të mëtejshëm të ekonomisë me pastrimin e parave dhe deri rrezikun fatal të fuqizimit të grupeve kriminale, që kontrollojnë si kultivimin ashtu edhe tregtimin e tij.

Për zonat malore mund ti rendisim disa problematika që lindin nga kultivimi i narkotikeve:

Zhvendosja e vëmendjes nga bujqësia (kush nuk e kultivon do të duhet si "spion"). Kullotja e blegtorisë u bën e kufizuar dhe me rreziqe. Në zonat ku janë kultivuar narkotike dhe qark tyre është ndaluar lëvizja e njerëzve dhe blegtorisë. Ata që merreshin me blegtori filluan të heqin tufat dhe filluan punësimin në punime të kultivimit të narkotike. Frika se mos bagëtitë mund të dëmtohen nëse konsumojnë prej bimëve narkotike, i ka trembur së tepërmi blegtorët, të cilët janë vënë realisht në dilemë nëse duan të vijojnë aktivitetin.

Përhapja e përdorimit të hashashit të rinjtë. Vendi ynë nuk është vetëm një rrugë tranziti e drogave ilegale, por ajo është vendi ku droga kultivohet dhe se përdorues të drogës janë kryesisht të rinjtë shqiptarë. Në ndryshim me çfarë mendohej më përpara, ku kanabis konsiderohej drogë e lehtë dhe e parrezikshme, tani studimet tregojnë për prekjën dhe të shumë sistemeve të organizimit nga përdorimi i marijuanës (mëlçi, zemër), etj.

Kultivimi i drogës dhe konsumi i saj është burimi më i madhor i konflikteve sociale në vend. Vrasjet, burgimi dhe dhuna në familje shkaktohen apo lidhen në mënyrë direkte apo indirekte me së shumti me aktivitetin e drogës. Disa studime e kanë treguar lidhjen që ka përdorimi i marijuanës me të ardhurat e ulëta, papunësinë, sjelljet kriminale dhe për pasojë nivelin e ulët të jetesës.

Kriminalizimi i përsheptuar i ekonomisë me pastrimin e parave të gjeneruara nga ky aktivitet i jashtëligjshëm. Pastrimi i parave është procesi përmes të cilit të ardhurat kriminale shndërrohen në të ardhura "në dukje" të ligjshme. Fushat ku janë investuar para me origjinë nga ve-

primtari të organizuara kriminale janë të larmishme dhe përfshijnë pothuaj çdo lloj veprimtari ekonomike. Ekspertët vërejnë se pjesa dërrmuese e "parave të pista" është investuar në fushën e ndërtimit, ku pas vitit 2000, në Shqipëri, filloi të vihej re një "bum" ndërtimesh që nuk përputhej me nivelin ekonomik të vendit. Sipas ekspertëve dhe raporteve të ndryshme, fusha të tjera përfshijnë biznese si hotele, restorante, karburante, veprimtari prodhuese, fabrika moderne përpunuese, kompani import-eksporti, infrastrukturë, prodhim energjie, biznese të lojërave të fatit, miniera, turizëm dhe agjenci turistike. Së fundmi, fuqizimi i mëtejshëm i ndikimit politik dhe ekonomik i krimit të organizuar do të kërcënonte në mënyrë serioze standardet dhe vlerat morale të përbashkëta të shoqërisë, duke dobësuar strukturën e saj tashmë të dërrmuar nga fenomene të lidhura me diktaturën komuniste, që e deformati për 50 vite me radhë dhe më pas me tranzicionin apo me emigracionin masiv, që kanë lënë plagë serioze.

Deformimi i vullnetit të votuesve dhe vote. Dekriminalizimi i politikës ishte një nga çështjet më të nxehta të muajve të fundit, si një dëshmi e qartë që paratë e përfituara në mënyrë të jashtëligjshme kanë kapur tashmë edhe institucionin më të lartë ligjvënës. Por, shqetësimi më i madh mbetet në faktin që paratë me origjinë nga hashashi mund të përdoren në zgjedhjet e ardhshme dhe të denaturojnë votën e lirë edhe më shumë nga sa e kanë telenditur këtë të fundit këto kohë. Blerja e votës duhet të përcaktohet qartë në ligj dhe duhet të jetë objekt sanksionesh proporcionale dhe efikase", thuhet në raportin e vëzhguesve.

Fuqizimi i krimit të organizuar Krimi i organizuar është i shtrirë në mbarë territorin e vendit, duke prekur drejtpërdrejt ose tërthorazi shoqërinë shqiptare. Grupet kriminale që merren me trafikun e drogave të forta janë më të sofistikuara dhe dyshohet se kanë vendosur lidhje të qëndrueshme me individë të korruptuar brenda agjencive ligje zbatuese, elitën politike dhe sistemin gjyqësor.

Rritja e paqëndrueshme dhe iluzionet e fitimeve të lehta. Më e rrezikshme është se orientimi drejt këtyre aktiviteteve me norma të shpejta kthimi po shmang vëmendjen nga riorientimi i nevojshëm i ekonomisë drejt sektorëve të qëndrueshëm, duke krijuar një situatë të ngjashme me atë të viteve '95-96, ku njerëzit u pasuruan me shpejtësi, pa punuar, por duke investuar paratë e tyre në "piramidat" që mbinë si kërpudhat në atë periudhë të toleruar dhe të pa ngacmuar nga shteti i kohës.

Thjesht, hashashi po rrezikon të kthehet në fluskën e radhës në ekonomi.

B. Mundësi Punësimi në pyje, kullota, bimët mjekësore dhe Ekoturizem

Po ndalemi tek disa të dhëna vetëm për bashkinë Shkodër

Bashkia Shkodër, ka në pronësi këtë fond pyjor dhe kullosor ku rriten dhe zhvillohen në gjendje natyrore shume bime

mjekësore, tanifere e eterovajore.

shqipës.

Fondi pyjor dhe kullosor në Bashkinë Shkodër.

Totali	Pyje	Kullota	Sipërfaqe me bimësi pyjore	Sipërfaqe inproduktive
43806	30993	5377	851	6585

Në juridiksion të kësaj bashkie janë dhe dy zona të mbrojtura si Parku Kombëtar i Thethit, me sipërfaqe 2600 ha. Peizazhi mbrojtur Lumi i Bunës Velipoje rreth 23 000 ha. Në sipërfaqe të konsiderueshme nga Zona e Mbrojtur e Liqenit të Shkodrës i takon respektivisht kësaj bashkie.

Në fondin pyjor sipas planeve të mbarështimit të hartuar për ish Komunitat sot Njësi Administrative mund të kryhen punime kryesore:

Rrallime dhe ricungime në dushkaja 500ha/vit

Pyllëzime të tokat e zhveshura dhe inproduktive 150-200 ha/vit

Luftim kanceri dhe shkallëzime në gështenjë 200-300 ha/vit (Sipërfaqe totale me gështenjë, në bashki është rreth 3000 ha)

Punime në kullota (lera dhe hauze) 10-12/cope në vit.

Realizimi i këtyre punimeve për veçse fondeve për financim që duhet të sigurohen nga bashkia dhe donatorët të tjerë, kërkojnë një numër të konsiderueshëm fuqie punëtore, e cila thuhet gjithë vitin mund të merret me këto punime.

Në fondin e bimëve mjekësore e tanifere. Në grumbullimin dhe përpunim përgatitor mund të punësohen në periudhe sezonale (Maj -Tetor) mbi 200 veta. Janë rreth 50 lloje bimësh me vlera që i grumbullon tregu.



Kultivimi i frutave të pyllit dhe i bimëve të rralla, është një mundësi reale punësimi, që siguron të ardhura të konsiderueshme (Në vend të kanabisit kultivoni: Gentianën, agulicë, boronica, mjedrrra, etj)

Prodhimet të dyta pyjore.

Grumbullimi, përpunimi dhe eksporti i gështenjave nga Pulti (Sipas përvojës që ka Reçi)

Prerja dhe përpunimi i shelgut nga Lugina e Shalës dhe Kirit

Nxjerrja e përpunimi i rrënjëve të

Ekoturizmi dhe format e tjera të turizmit në natyrë janë drejtim kryesorë punësimi sidomos për të rinjtë, që kërkon shumë forca pune dhe kryesisht të kualifikuara.

Shkodra sot e ka në dy objekte kryesore turizmin në Velipoje dhe Theth. Është me vend dhe merr shumë rendësi dhe promovimi i Luginës Kirit në gjithë gjatësinë e saj. Lugina Brucajve thuhet është tërësisht e pa njohur

Shtegtimi turistik nga Shkodra në Prekal-Shosh deri në Breg Lumi Shalës, duke u kthyer nga Thethi e bën këtë një nder "Unazat turistike" më të veçanta dhe me shumë vlera në Ballkan.

Nga Shkodra si pike kryesore e turizmit të shumëllojshme mund të ndërmerren shtegtime ekoturistike drejt zonave të dukshme të Mbishkodrës; në zonat fushore, kodrinore deri në ato malore. Janë këto shtegtime që mund të kryhen në këmbë dhe në biçikleta.

Sa thuhet e përruar për turizmin, duhet që çdo Njësi Administrative deri në nivel fshati tashme të mund të identifikojë jo vetëm rrugët e lëvizjes dhe objektet me vlera turistike, por dhe familjet që mund të jene në shërbim për pritje turistëve vendas dhe të huaj. Për komunikim, me këta të fundit sigurisht kërkohen të rinjtë djem dhe vajza, që dine dhe komunikojnë në gjuhë të huaja.

Tashme, në Shqipëri ka mjaft modele të zhvillimit të turizmit në fshat, në nivel fermash, nivel bujtinash etj.

Malet tona ende nuk janë shkelur dhe ende më pak të jene të njohura për vlerat e tyre. Janë me dhjetëra shpella e monumente të tjera natyrore, që kërkohet të njihen dhe eksploroohen në të ardhmen.

**Inxh. Gjon FIERZA,
Prof. As. Dr. Zef GJETA
Shkodër, më 29 Shkurt 2020**

LUMJA UNË, QË TË PATA VËLLA!

Prena Mark Saduku kujton: Si u arratisa familjarisht së bashku me At' Danjel Gjeçajn, Martin Camajn e të tjerë Prele MILANI

Prenë Markja, kështu e thërrasin dhe njehin Dukagjini si bijën e vet shembullore. Është vajza e fundit e interpretit të njohur të kanunit të maleve tona Mark Sadiku dhe stërmbesa e prijësit historik të Djelmisë së Shalës Mehmet Shpendi. Prena është një grua shembullore, fisnike si vetë dera e saj, më fort burrë se grua. Sjellja e saj plot mirësi kudo i shkeli këmba, njerëzia, bujaria, zgjuarsia dhe zotësia për punë të vlefshme që i ranë për dore e bëjnë të çmohet e nderohet nga vendlindja dhe nga mbarë shoqëria ku jetoi qoftë në Shqipëri dhe në mërgatën shqiptare të Evropës së lirë. Është 90 vjeç (dt 26 korrik 1930) por nuk njeh pleqni as në paraqitje, as në shëndet, as në shqisa. Prena është dëshmitare e vetme e gjallë e asaj artitise të bujshme të At'Danjel Gjeçajt, Martin Camat dhe një çete prej 36 armiqsh politik të regjimit komunist të Tiranës. Pikërisht për këtë ngjarje e pyeta çikën e Dukagjinit të prononcohet për gazetën "Dukagjini"

Që kur e keni njohur At' Danjel Gjeçajn dhe në çfarë rrethanash e keni njohur?

Për herë të parë e kam takuar në Rragam të Thethit, në gusht të viti 1948, kur fati na bashkoi një çetë të madhe antikomuniste. Ka qënë ngjarja më dramatike e jetës për secilin nga ne. Prej tmerrit për t'i shpëtuar furtunës së kuqe u detyruam, me zemër të plagosur, t'i kthyenim shpinën vatanit. Unë isha vajzë 18 vjeçe bile edhe e fejueme në shtëpinë e Zef Marashit të Kirit. Vëllezni Sadiku dhe Gjetaja e kishin nda mendjen të arratiseshin. Kishin dalë në mal kundër regjimit, që në fillim të 1945-ës, ishin dorëzuar dhe ishin burgosur në burgun e Shkodrës. Edhe pasi u liruen po i përndiqnin dhe vetëm burgu i priste prap shpejt.

Sadikun, Gjeton dhe Prelë Markun i patën thirr një ditë në Breg Lumit duke i pyet për gjera të ndryshme krejt pa lidhje, natyrisht ishte formë presioni që ju behej ose me i bashkëpunëtorë ose me futë brenda. Ju thanë që shkoni dhe pas nesër hajdeni prap me dhanë sqarimenë Rreth në Kodër Shëngjergji. Një polici nga Puka që nuk e di se nga e nihte Prelë Mark Bajraktarin kure u ndanë i dha një pusull. ku shkruhej:-Ti mos u tut por ata shokët tu kanë punën pisk! Gjatë kthimit letrën e lexuan dhe morën vendimin e prere se do të arratiseshin. Prelë Marku ka hezituar duke arsyetuar:- Nuk kemi ba gja e nuk ka me kenë gjë me rendësi. Kanë thirr edhe Marsh Kolë Hajdarin që ishte i shkolluar e nënpunës në rreth. Marashi nuk ka hezituar hiç dhe u ka dhenë besën. Prela ka qënë i fundit në vendim marrje, pasi gruan e kishte shtazënë, por nuk mund ta linte pas dhe ashtu shtazënë e mori me vete.

Ndërsa unë bashkë me nanën çuem një lopë për kryegjaje në Pult. Ka qënë fundi i korrikut 1948. Kami në shtëpi pasi duke përshkruar në këmbë rrugën Kirë-Plan-Qafë Boshit, Pecaj Sa kam hy në shpi pa u mbushë mirë me frymë Gjetaja me tha:

- Çohu, bahu gati shpejt se do arratisemi.

- Jo more vëlla! Nuk ashtë punë për mue. Jam vajzë e ku do të shkoj malit?

- Nuk mund të la mbasi të tretin interni-meve dhe të keqtrajtojnë komunistët!

- Jo, jo nuk mund të vij, po nanën ku me lanë?

- Nuk mund të lash nanën apo të fejuemin?!

- Mirë pra, më prijë se erdha.

U nisa, ashtu si kisha ardhë nga rruga së bashku me dy vëllezërit Sadikun dhe Gjeton kunatën (nusja e Gjetos, Age Vocja) e bija e Voc Dedës së Kirit, Marash Kolën prej Pecajve një burrë i mrekullueshëm, i kulturuem dhe i mirë arsimum pinjoll i shtëpisë zaplotë të Bal Tonës, Prel Markun djalë i Bajraktarit të Shalës së bashku me Zojë Sokolën, e cila ka qënë shtatzanë.

Jemi bashkue me grupin e Nikaj -Mërturit që vepronte në bjeshkë të Vuksanajve e drejtohej nga Nikë Sokoli. Në Rragam u bashkuem me shumë koçakë të tjerë dhe me Mark Prelën (që pati marrë emnin rregullator Danjel Gjeçaj). Me shtëpinë tij të veçume kishim jo vetëm njohje e dashamirësi, por edhe kumari. Lek Currin, vëllai im Sadiku e kishte kumarë, Mark Prela pra ishte nipi i Lekë Currit. Më kujtohet si sot, masi Danjeli binte në sy si djalë i qetë, i thjeshtë, i sjellshëm e mjaft i pashëm. E di shëm që më përpara se ishte frat. Aty në mesin tonë ishte i veshun si ne, me pantallona stofi, një këmishë të errtë dhe një xhakëtë kadifje të zezë. Kishte një çantë që mbante në shpinë. Ju përshtat shumë mirë malit pa kurrfarë përçmimi u ba një me njerëzit e çetës që ishin ma pak ose aspak me shkollë.

Vetëm kur ndokush merrte vrull si guraleci në rrgallë, ndërhynte e mirëpeshonte dhe qetësonte situatën. Afër Danjelit rrinte e nuk i ndahej një djalë fillikat, i gjatë, shtathedhur i urtë që nuk i nihej zani. Edhe për atë thoshin së është mësues e kishte ikë nga Prekali nga frika e arrestimit. Në mal, mes koçave mësova se qe quhej Martin Camaj, ishte nga fisi i Temalit që ma vonë u ba ndera e Shqipërisë.

Sa zgjati aventura e arratisjes dhe kush u ndihmoi që të kaloni pa ra në grackën e kufitarëve?

Nga Thethi në Dënell deri në Rragam kemi kaluar natën rrugë e pa rrugë. Jemi ndalë në bjeshkën e Rragamit në mes të një pylli të dendun, ku kemi qëndruar afërsisht dy javë. Kemi fjetë në podina jashte dhe lëndina barishtore, afër burimeve ujore të mrekullueshme. Po ç'e do atë ujë të kristaltë kur në bark zorret na oshtinin nga uria. Kishte aty në lëndina plot bagëti, por mos o zot askush nuk ka vu dorë në to. Edhe pse në vulkun e verës natën, kemi vuejt jo pak prej të ftohti. Ishte bjeshkë e naltë, dhe zjarm kishim frikë me nezë se na paditte tymi. Sa binte dielli dilnim e shpisheshim në rreze si dhinë e egra që i çelë drita shkrepave të shkretë.

Si jeni ushqye për një kohë kaq të gjatë?

Bukë dhe ushqim çdo buzë mbramje na ka sjellë Ndre Cufa nga Gjelajt e Thethit që dritë i baftë shpirti! Po mos të kishte qënë Ndreu nuk e di si dhe ku do kishim përfundue. Ai na ushquu me sa kishte mundësi, kuptohet se nuk na mjaftonte, por

jeta koçakut ashtu ishte.

Qëndruem kaq gjatë pa kalue pasi kishim frikë se mos do t'na kthenin mas pala jugosllave. Nga mesi i javës dytë, Ndreu na thotë se ju kanë diktue forcat e ndjekjes. Nuk pritëm ma gjatë, udhëtuem natën pa hanë për shkapërcimin e kufirit madje pa e ditë mirë se a jemi në tokën tonë apo jugosllave. Prej Vuthajsh zbritëm në Guci. Kapiten Gjon Destanisha, Nikë Sokoli, Marash Kola, Pal Ceka ishin drejtuesit e grupeve. Unë kam ecë hap mas hapi me Sadikun dhe Gjeton. Nuk pranova të rrija ka funi i karvanit Vëllezni ishin të dy të armatosun e po të kristë pushka doja



të isha në krah të tyne e gjallë a e vdekun. Isha nisë për të mos u kthye mrapa e gjallë. Kur kisha lanë mas nanën dhe këputë fillin e fatit martesor nuk e kisha ma problem për asgjë. Ka deshtë zoti dhe me shumë sakrificë kemi kalue kufirin shnosh e mirë dhe jemi ndalë në një vend që quhej Za Stan. Këtu jemi ndalue nga forcat jugosllave, Gjetaja, vëllai që dinte serbisht ka shkue vetë i dyti dhe u ka tregue autoriteteve se kush jemi, sa jemi dhe pse jemi arratisë. Në Guci na kanë shoqëru me forca policore dhe strehue kolektivisht në një objekt tip magazine. Na kanë dhanë miell kallamiqi me zije kaçamak. Vat Marashi i Shoshit që i vinte dora për gatime ma mire se çdo stajanice gatoi plot një kazan. Për fatin tonë jo të mirë kazani që na dhanë kishte pas vajguri dhe gjithë munda Vatës i shkoi kot, ndërsa Danjel Gjeçaj, duke qeshë thoshte:

Bini burra n' kaçamak

Hani shumë e leni pak

Si vazhdoi aventura juaj në Jugosllavi dhe ma tej?

Të nesërmen një bijë nga Lekajt e Shalës e martume në Guci na ka pru tri bukë kol-lomoqi e djathë. Nikë Sokolin e Btoshtës bashkë me të nipin e kanë futë menjherë në burg, ne të tjerët ishim të gjithë me roje dhe në mbikëqyrje nga sigurimi jugosllav. Unë me vëllezërit, kunatën, Danjel Gjeçajn gjetëm strehë te Vocër Bala i Shalës, që kishte emigruu para lufte në Guci, Vocri ishte daja i Ambroz Martinit xhakue nga Thethi, shok i ngushtë i At Danjel Gjeçajt. Pas 12 ditësh na kanë thanë: Ngehuni se do lëvizni nga këtu. Na hipën në një vagon, ishim të rrethuem me roje e ushtarë. Na kapi paniku se mos pa na kthenin në Shqipëri.

Në mesin tonë kish ra një hije si morde. O me gojë, o me mend thonim – Eh kaq e pat, mbaruem të gjithë. Kur mas një kthese të gjanë e kur lokomotiva ndryshoi drejtim, vëllai Gjetaja që kishte qënë në Jugosllavi e kuptoi se në ç'drejtim po lëviznim na dha sihariqin.

-Qebesa shpëtuem. Treni po lëvizë drejt Podgoricës!

Si dielli që zbon mjegullën nga kreshtat plisbardha, ashtu u skjarën fytyrat tona. Nga gëzimi shpërtheu kanga e gjatë maja krahut sikur të ishim në maje të Arapit. Ndërsa shumica këndonin si me qënë dasmorë në një ndenjësë më vete Danjel Gjeçaj lutej e thoshte uratë për ne! Në Jugosllavi me at Danjelin kam qëndruu plot dy vite. I kam la rrobat e shërbye si vëllezëne të mi. Në vitet e para të qëndrimit në Jugosllavi ka punue fort e pa fjalë me punë fizike për hapje traseje e shtrim rrugësh.

Pas punës së lodhshme të gjithë shtriheshim e pushonim në do dyshekë pambuku të shtrirë direkt ne dysheme prej dërrasash,ndërsa Danjeli lexonte libra se nga ku i gjeti nuk e di dhe shkruente ne disa fletore shkollore.

Nga kampet e punës në Jugosllavi Danjeli gjeti udhën e shumëdëshiruar të meshtarisë dhe të studimeve elitare. Ju dhe vëllezërit fati u çoi në tokat franceze si ndodhi kjo zgjedhje vetë apo ju dërguan spontanisht?

At' Danjeli, Martin Camaj, por Ambroz Martinin, Lin Delinë që gjetëm atje ishin njerëz të letrave të diturisë dhe mas sakrificave të para gjetën ma lehtë rrugën e fillimit të jetës së re në fushën

e diturisë. Për ne ishte ndryshe, na u desh të punojmë, të lodhemi, të djersitemi dhe të integrohemi me dinjitet në një shoqëri dhe shtet që nuk e kishim pa as në andrra. Nuk ka qënë në dorën tonë përzgjedhja se ku do të jetonim, por mue dhe familjes time dhe disa të tjerëve na ra për hise Franca:Danjel Gjeçaj shkoi në Romë dhe bani emën në gjithë mërgatën shqiptare të diaspores. Ai ashtë aq i madh sa unë nuk mund të jap vlerësime, për studimet, për librat as për kthime te tij. Jam fiks 90 vjeçe dhe në jetën teme nuk kam pa shqiptar ma të njerëzishëm, më gojë mjalë, mirënjohës. Nuk them se kam e dashtë ma shumë se vëllezni, por prej tyne nuk kam ditë me nda. As vitet që rrjedhin si lumë, as largësia dashamirësinë, dhe respektin familjarë nuk e ka zbehur kurrë për këtë njeri të mirë. Sa herë ka ardhë në Francë nuk ka ikë pa bujte tek ne ose te Marash Kolë Hajdari të cilin e kishte mik buke, këndimesh, shkrimesh e diturie. Na ka dërgue sa e sa letra duke na pyetë për çdo hall. Kur ashtë takue me Pader Gjon Palin e II-të më ka dergue me dedikim fotografinë që kanë pozue së bashku te cilën e ruaj si një nga dhuratat më vlera që disponoj. Gjithmonë më ka thanë motër.

Nga respektit që kishte për të paret e mi më ka vlerësue edhe ma tepër se e meritoja prandaj më thoshte –Moj Prenë, ti bija e Mark Sadikut, mbesa Mehmet Shpendit dhe çika e tanë Dukagjinit! Më ka ftue disa herë për festat e lumnueshme të Krishtlindjes. Një rast pasi kam dalë në pension për 15 dite më shoqëruen në të gjitha kishat kryesore të Romës. At Danjel Gjeçaj ashtë i pari shqiptar që ka shkruu një libër për "Mehmet Shpendin e Mark Sadikun" e Shalës. Ky libër i bën nder jo vetëm familjes time, por Dukagjinit dhe historisë. Ketë njeri me hire shejti pata fatin ta njoh në ditët ma të vështira e ma të begata të jetës! Lum Kisha, Dukagjini dhe Shqiptaria qe të pati Lumja unë që të pata vëlla!

**Bashkëbisedoi
Prele MILANI**

MONSINJOR ANTONIN FISHTA

Ipeshkvi i shquar shqiptar Imzot Antonin Fishta lindi në Shkodër, më 13 prill 1902. Ndjeu shpejt thirrjen rregulltare, që e shtyu të hynte në Kuvendin Françeskan të Gjuhadorit. Kreu mësimet fillore e të mesme në Shkodër e Troshan, për ta vijuar përgatitjen në vise të ndryshme françeskane të Italisë. U shugurua meshtar në moshën 25 vjeçare, më 14 gusht 1927 dhe filloi shërbimin si profesor në Liceun "Illyricum" të Shkodrës. Më pas qe dërguar famullitar në Abat të Shalës, në Dukagjin. Që nga viti 1948 mbajti vendin si i deleguar ipeshkvnor në Pult. Më 1956, në rrethanat dramatike të presionit të diktaturës për shkëputjen e Kishës Katolike në Shqipëri nga Selia Apostolike, u emërua ipeshkëv i Pultit, duke zëvendësuar kështu ipeshkvin e fundit që kishte mbetur gjallë pas kërdisë së diktaturës mbi hierarkinë katolike, Imzot Bernardin Shllakun, vdekur në nëntor të vitit 1956. Kjo ngjiste pak kohë pas bisedës së Mehmet Shehut me Imzot Shllakun. Mehmet Shehu e pati thirrur Imzot Bernardinin në Kryeministri dhe i pati bërë propozimin për emërimin e katër ipeshkvijve të rinj. Selia e Shenjtë nuk emëroi asnjërin prej tyre, por zgjodhi, ajo vetë, dy të tjerë: Imzot Ernest Çobën, për kryeipeshkvinë e Shkodrës dhe Imzot Pjetër Demën, për kryeipeshkvinë e Durrësit. Më vonë, me propozimin e Imzot Çobës, Selia e Shenjtë emëroi dhe dy ipeshkvij të tjerë. Njëri ishte Imzot Antonin Fishta, tjetri – Imzot Nikollë Troshani, shuguruar në prill të vitit 1959, si ipeshkëv i dioqezës së Durrësit, në vend të Imzot Pjetër Demës që kishte vdekur.

Imzot Antonini u shugurua më 25. 04. 1957 ipeshkëv ordinar i Pultit në Katedralen e Shkodrës nga Imzot Ernest Çoba. Selinë Ipeshkvnore e pati përkohësisht në Abat, ku vazhdoi të kryejë edhe detyrën



e famullitarit, derisa u mbyllën kishat e edhe ai vetë u mbyll në shtëpinë e të afërmeve në Shkodër, ku edhe vdiq më 14 janar 1970, për t'u varrosur në Rrëmaj në heshtje të plotë.

Mbeti në kujtesën e besimtarëve si bir i vërtetë i Shën Françeskut. Me trup vigan, me këmbët e zbathura dimër-verë, mbathur vetëm me sandalet e thjeshta françeskane, ai dukej sikur nuk ecte, por fluturonte. Me atë çap u ngjitej maleve të thepisura e po me atë ecte ndërmyjet bankave të shkollës, kur jepte mësim. Kishte pamjen e fratit-malësor.

U shqua jo vetëm për shërbimin meshtarak e ipeshkvnor, që ishte misioni i tij kryesor, por edhe si muzikant, historian, poet. Shkroi disa shqyrtime dhe studime historike si: "Ma i pari frat në Shqipëri" (1930); "Skanderbegu e françeskajt" (1930); "Emzot Luigj Çiurçija" (1931); "Doktor Milan Sufflay ndër shkrime të veta" (1931); "Njëzet e

pesë vjetori i Kongresit të Manastirit" (1933). Interes të veçantë paraqesin edhe biografitë e shkruara prej tij për Filip Shirokën (1935), Dom Ndre Mjedën (1937) e historianin Theodor Ippen (1935). Si poet u bë i njohur me poemën "Fatosave", botuar më 1912; si studiues i gjuhës, me studimin kushtuar Atë Françesk Rosit dhe shkrimeve të tij; si rrëfimtari, me portretin "Tribuni i Traboinit, Dedë Gjo' Luli" (1937) dhe me shumë artikuj të tjerë botuar te "Hylli i Dritës". Askush nuk ka menduar deri më sot t'i mbledhë në një këto shkrime, të cilat nuk e kanë humbur vlerën as aktualitetin. Mbeten gjithnjë të shpërndara, duke pritur një dorë të zellshme, që do t'ia kthejë kulturës shqiptare frytin e pendës së Imzot Antonin Fishtës së madh, që kaloi gjithë jetën në shërbim të Fesë e të Atdheut mes bjeshkëve vigane të Veriut.

Njohja e ime, me MonsinJOR Antonin Fishten:

Kleriku në fjale pasi shërbej me devocion në Shalë nga viti 1957-u largu për në qytetin e Shkodrës. Disa fshatar nga Prekali, që ja dinin vlerën, i thane ktheju e qëndro këtu në fshatin tonë, se jemi marre vesh me komunistet e nuk të shqetëson njeri. Ashtu u be, qëndroi në Prekal deri me 26-Mars 1967, të dielën e Pashkëve, kure ishin mbylle të gjitha kishat, institucionet e të gjitha besimeve, ky pranoj dhe çoj meshën e fundit në gjithë Shqipërinë dhe pa ju tremb syni nga regjimi komunist e lufta e tmerrshme kundër fesë dhe sidomos asaj katolike!

Erdhën me fëmijë për ti pagëzuar e krezmuar me qindra besimtar nga të gjitha fshatrat e zonës së Dukagjinit, zbriten në Prekalin Turistik. MonsinJOR Fishta, ja çfarë predikoj: "Vllazen e motra! Po ju

them një predikim, i cili asht zgjedhe nga ana ime, që i përket ditës sotme në mujsha me qëndrua, por edhe ju merrni kurajën të qëndroni, se ky qante së bashku me pjesëmarrësit ka fliste. Po ju them e po filloj me Jezu -Krishtin:

-E thirri në takim Jul Çezari dhe i tha pse nuk i merr vesh porositet e mija, por vazhdon në rrugën tende?!

-Ky, pasi i kthej përgjigje erdhën disa dhe vrapuan drejt tij Mjeshtër: Mjeshtër të lutem na trego se po na kërkon taksat Çezari, a t'i japim atij?

-Jezusi ju përgjigj ...Jepni Çezarit çka asht e Çezarit dhe jepni Zotit çka asht e Zotit! Qeveria në toke e Zoti në qielli. Qeverise bani punën, po mendjen e zemrën ti mbani te Zoti.

Kishat, tha u mbyllen, por njerëzit besimin ta mbajnë në zemër.

Do të lindin fëmije, pagëzoni me ujë burimit, ku të jetë i pa shtershim. T'i thoni në emën të shoquem me fjalët: "Unë po të pagëzoj në emën të Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjt!"

Pagëzoj, krezmoj e bekoj të gjithë sa erdhën, rrëfej e kungoj të nesërmen.

Kur u largu, u përcjell jo vetëm nga të besimit Katolik, por dhe të nga besimtar mysliman nga fshatrat e Postribës.

Duke ecur drejt Shkodrës: Padre, Padre, të lutem na beko ishin gra me fëmije, që dilnin në rrugë dhe përkuleshin.

Organizata baze e partisë e fshatit Prekal, duke bashkëpunuar me lokalitetin Postribe, MonsinJOR Fishtës i shkruan biografinë e mire dhe shpëtoi nga burgu komunist. Ky ndërroj jete, e la zemra me 14 Janar 1970. I vetmi klerik në Shqipëri, që i shpëtoj burgut komunist. Paçim bekimin e tij! I gjithë populli qau kure e përcjellën pa dallim besimi.

Shtoj se, unë isha aksionist dhe mora pjese në meshën e tij!

Pastë drite shpirti i tij!

Amen!

Përgatiti NOSH VUKSANI,
Raconigi - Cuneo Pizza, Itali

KISHËS SË SHËN PRENDES NË UKBIBAJ SHLLAK I SHTOHET EDHE NJË KRYQ

Kishës së Shën Prendes në Ukbibaj Shllak i shtohet edhe një kryq ndriçues me përmasa të mëdha, dhurate për kishën në zonën e Shllakut nga Edmond Gjoni, me banim në SH.B.A. Kushdo që udhëton drejt Shllakut, sapo kalon Drishtin e Vilezën gjendet fshati Ukbibaj, që bie në sy Kisha e Sh. Prendes. Kjo kishë është në troje shekullore, ku për shtegtarët që udhëtonin nga Shkodra drejte fshatrave të Shllakut, Temalit, Dushmanit, Toplanes ishte një pike pushimi. Për udhëtarët që udhëtonin në këmbë e me barre në shpine të kthyer nga tregu i Shkodrës, që kalonin natën në qiellin e hapur dhe për karvanët

e bagëtive, ishte një vend i shenjte dhe mbrojtës.

Ishte viti 1994, ku misionari i fretërve San Piu X Pater Roland de Merode i ardhur nga Franca dhe me mbështetjen e banoreve të Ukbibajeve do të vendoste të ndërtohej Kisha e Shna Prendes. Gurin e pare e vendosi kryeplaku i fshatit Ded Gjon Zojza duke plotësuar një amanet të të pareve të tij. Fale bujarisë së familjes Bala, që dhuruan token, hedh themelet kisha e Sh. Prendes. Ishte famullitari i Shllakut Dom Ardian Arra, i cili punoi fort që ky vend të jete një qendër e rëndësishme sociale-kulturore, ku u ndërtoua shkolla 9-vjeçare, qendra shëndetësore, një pishinë e mrekullueshme e një objekt kulturi për Shllakun.

Pas kthimit nga Amerika për pushimet e Verës që lame pas, Edmond Gjoni vizitoi varrezat e të parëve dhe ambientet e kishës së Sh. Prendes në Ukbibaj. Ishte një vizite që e shtyu t'i dhuronte kishës një kryq me përmasa të konsiderueshëm, lehtësisht i dallueshëm nga distanca në oborrin e kësaj kishë. Si fillim, së bashku me të afërmit e tij diskutuan pozicionin më të mirë. Sipas studimit të projektit

të bere nga inxhinieri Elton Ndoc Zojza, pas një pune të palodhur u realizua ndërtimi i kryqit me profil hekuri. Përmasat e kryqit janë 8 m i gjete dhe dy krahët se bashku 4 m me një profil hekuri, 200 mm x 100 mm profil dopie "T" i betonuar në



thellësinë 1.5m.

Gjate punës teknike 6 mujore u studiu mundësia e montimit, boja ndriçuese dhe dritat e ndriçimit. Do të ishte data 11 janar 2020 ku do të behet vendosja përfundimtare e konstruksionit. Kryqi me përmasa të mëdha jep një refleks të bardhe. Fale ndriçimit elektrik LED, të instaluar për gjate gjithë gjatësisë së trupit, jep ndriçim natën dhe shuhet në daljen e dritës.

Në ndërtimin dhe montimin tij ndihmuan Gjergj Kol Zojza, Tonin Ndoc Nika (kamionist), Lek Zojza, Pjeter Gjoni, Ndoc Zojza, Pjerin Zojza, Mond Hebaj dhe inxhinieri Elton Zojza. Tashme ky kryq është një busull orientuese për udhëtarët, që është i dallueshëm në Thep, Zbuq, Vukaj, Fushe Rade, Barcolle e Lajthizë.

Fale financimit të Edmond Gjoni, Shllakut i shtohet një vlerë e çmueshme, një nisem edhe për emigrantet shllakas që jetojnë e punojnë në bote për të investuar në trojet e tyre, ku në mjaft "kisha varresh" në Shllak, Temal (Dushman), nuk është e mundur të shkohet me makine apo një kapele për tu lutur për të paret tanë.

Përgatiti Zef NIKA

NJI PËRJETIM I MREKULLUESHËM: P JESA E GJERGJ KOLËS PËR MARTIN DHE ERIKA CAMAJN

Falenderojmë z. Hans-Joachim Lanksch për mesazhin e shkrimin e mëposhtëm:

Mirëdita!

Më 22 korrik, në Mynih, u dha premierë vepra “Shpirti i poetit i vizatuem në sytë e gruas së tij” për Martin Camajn dhe gruen e tij, Erika, nga autori shkodran me banim në Vjenë Gjergj Jozef Kola.

Ishte një eveniment i jashtëzakonshëm. Bana një shkrim të vogël. Ju lutem me e botue.

ju përshëndes, Hans-Joachim Lanksch

Dje, tue u shëtitë, kalova pranë një librerie ku në vitrinë më ra ndër sy një titull: Ka momente ku gjithçka na del mbarë. Një moment i tillë ka kenë mbramja pardje, konkretisht shfaqja e pjesës teatrale e Gjergj Kolës “Shpirti i poetit i vizatuem në sytë e gruas së tij”.

Pjesa e Gjergj Kolës asht një dialogim mes dy vetesh (Martin dhe Erika Camaj) me anë të letrave që i shkruajnë njerit-tjetrit. Nji letërshtëmbim mes Martinit dhe Erikës nuk ekziston resp. nuk asht



dhe me respekt dhe simpati të madhe për gruen e tij Erika. Rezultati asht një pjesë jashtëzakonisht e bukur, e shkrueme nga zemra dhe me zemrën e autorit.

Pjesa asht e koncipueme si lexim skenik, një gjini teatrale që – mund të gaboje – asht një risi në dramaturgjinë shqiptare. Realizimi i leximit skenik qe puna e regjisorës dhe aktorës Rita Ndoci dhe doli për mrekulli. Ndihej dora e saj e

dhe me respekt dhe simpati të madhe për gruen e tij Erika. Rezultati asht një pjesë jashtëzakonisht e bukur, e shkrueme nga zemra dhe me zemrën e autorit.

Pjesa asht e koncipueme si lexim skenik, një gjini teatrale që – mund të gaboje – asht një risi në dramaturgjinë shqiptare. Realizimi i leximit skenik qe puna e regjisorës dhe aktorës Rita Ndoci dhe doli për mrekulli. Ndihej dora e saj e

ndjeshme dhe kujdesshme. Pëlhura e tekstit poetik u gërshetue me muzikë romantike, e interpretueme me pasion nga pianisti shkodran me banim në Gjermani, Besar Mitku. Aktorja e mirënjohur Rita Ndoci e interpretoi rolin e mjekës së re e të dashunueme gjermane, Erika, me mjetet e aktorese së sprovueme që asht.

Poeti nga Shqipëria e largët dhe e panjohun, Martin, u luejt nga autori i pjesës, Gjergj Kola. Ai nuk e aktronte rolin e Martin Camajt – ai ISHTE Martin Camaj! Edhe në mishnimin e tij skenik të poetit Martin Camaj u ndie dashunia e poetit dhe dramaturgut Gjergj për poetin e madh Martin. Kur Rita Ndoci/Erika zu me këndue “Luleborën” dhe shkodranet e shkodranët e pranishëm zunë me iu bashkue kangës, nuk ishim ma në Mynih por në Shkodër... Të gjitha këto mrekullina u rumbullaksuen nga fotografitë artistike nga Leonora Milani.

Në sallë ishte një atmosferë e rrallë, ndihej pëlqimi i madh i publikut. Shfaqja doli bukur dhe autentik, ndoshta edhe për shkak të pranisë së zonjës Camaj. Qe një mbramje e paharrueshme. Shpresoj që ajo ka me u përsëritë, në Shkodër.

Gjergj Jozef KOLA,
22 Shtator 2018

A DUHET TË VRASË NJERIU?



Lekë IMERAJ

Në vitin 1984, gjenerali gjerman, Keissling, shkaktoi një “vorbull” në ploitikë, psikologji dhe filozofi, me thënien e tij se: “Gjithashtu, një ushtar i Ushtrisë së Kuqe sovjetike, është vëllai im!” Vorbulla përfshiu edhe komandon e NATO-s në Bruksel. Sa i përgjegjshëm dhe i ndërjegjshëm ishte gjenerali për thënien e tij!? Normalisht, nëse një ushtar tregon dashuri për armikun dhe e mendon atë vëlla, duhet larguar menjëherë nga radhët e ushtrisë. Ai nuk është aspak i gatshëm ta vrasë armikun, nëse do t’i duhet ta bëjë këtë. Për rastin e gjeneralit, u mendua se, një arsye e brendshme, e shtyu atë aq larg, sa deklaroi atë që një gjeneral, kurrsesi nuk duhet ta deklaronte. Edhe një ushtar, jo.

Gjenerali, megjithëse ishte bërë gjeneral për të vrasur dhe paguhej për të vrasur, nuk donte të vriste. Sepse morali i tij nuk ia lejonte këtë. “Mekanizmi vrasës”, atij nuk i funksiononte. Ashtu si dhe dhjetëra burrave të batalionit 101.

Megjithatë, a është çdo njeri i pajisur me “mekanizmin vrasës” dhe si funksionon ai?

Fjala është: a duhet të vrasë njeriu?

Kristina, 40 vjeçe, pyet: “A duhet ta vras unë xhaxhain tim, Thomain apo ai duhet të vazhdojë të jetojë?”

Kush është Thomai?

Thomai është një burrë, rreth të shtatëdhjetave dhe i shëndoshë si kokrra e mollës. Një burrë, që gjithë jetën e tij ka tiranizuar njerëz. Edhe vëllain e vet, babain e Kristinës. Kush nuk ka vuajtur nga ai. Të afërm, komshinj, të njohur dhe të panjohur. Gjithkush që ka pasur fatin e keq të ketë të bëjë ose të takohet me atë. Është martuar pesë herë. Tri gra i ka “ngrënë” për së gjalli dhe dy i ka ndarë. Ka pasur dy djem dhe që të dy, me dallaveret e tij, ua ka nxjerrë të tjerëve në pritë dhe i kanë vrasur. E gjithë jeta e tij është vetëm konflikte. Kush nuk e ka vrasur atë, me mend, sa dhe sa herë. Edhe Kristina. Ndoshta me dhjetëra herë. Ai është i pasur, shumë i pasur. Me ndërrimin e sistemeve, brenda pak viteve, ai u bë shumë i pasur. Bëhet fjalë për miliona. Trashëgimtarja e vetme është Kristina. Me kujdesin që ai tregon për jetën e vet, duket sikur nuk ka ndërmend të vdesë kurrë. E vetmja gjë që atij i intereson, janë paratë. Nëse ai vdes në moshën 90 vjeç, unë atëherë jam mbi 60, mendon Kristina. Kush mund ta dijë se, edhe nëse i marr milionat e tij në këtë moshë, mund të më hyjnë në punë. Nganjëherë i uroj xhaxha Tomit të vdesë që nesër. Përse nesër? Që sot. Pastaj bëhet pishman. Përse duhet të vdesë ai!? Përse duhet ta vras unë? Vetëm që të përfundoj konfliktin me të? Utilitarizmi filozofik nuk ia lejon këtë.

Jeremy Bentham (1748-1832), themeluesi i utilitarizmit filozofik, u lind në Londër. Ai ishte liberal, pacifist dhe mbrojtës i mendimit të lirë.

Dëshira e babait të tij, i cili ishte shumë i pasur, ishte që ai të bëhej avokat. Bentham studioi për avokat, por në jetë nuk u bë i tillë. Ai ëndërronte njeriun, jetën e liritë e tij. Iu përkushtua së drejtës civile, reformës sociale, mendimit të lirë, përmirësimit të jetës në burgje dhe mbështeti lëvizjen e parë të gruas. Arsyen e gjithë veprimtarisë së tij e përmbodhi në një ide të vetme: Lumturia është e mirë, vuajtja është e keqe.

Sipas kësaj ideje, qëllimi i shoqërisë duhet të jetë: “Sa më pak vuajtës dhe sa më

shumë të lumtur. Sa më shumë lumtur, që vjen në botë si rezultat i përpjekjeve, aq më e nevojshme dhe më e mirë është ajo. Këtë parim themelor, Bentham e quajti utilitarizëm.

Parimi themelor, vuajtja është e keqe dhe lumturia është e mirë, duket shumë bindës. Përse të mos përdoret në rastin e Xhaxha Thomait?! Ai nuk ka sjellë dhe as që ka ndërmend të sjellë kurrë lumturi në këtë botë. As për veten e tij dhe as për të tjerët. Edhe paratë e tij në bankë, nuk sjellin ndonjë të mirë për të tjerët. Është e mundur që dikush të ndryshojë diçka.

A nuk do të ishte më mirë që me paratë e tij të mjekoheshin fëmijët që vuajnë nga leuçemia apo sëmundje të tjera, për kurimin e të cilave u duhen shumë para? Paratë e një njeriu të lig, do t’i bënin ata të lumtur. Bentham ka të drejtë. Duhet shpërthyer arka e vjetër, ku mbahet e mbyllur lumturia e të tjerëve. Thomai duhet vrasur. Askush nuk do të derdhë asnjë pikë loti për vdekjen e tij. Përkundrazi. Të gjithë do të gëzohen. Do të gëzohen!?

Nëse e vret xhaxhain e vet, Kristina do të mund të ndihmonte disa fëmijë të sëmurë me paratë e tij. Xhaxhai është ligësia. Duke hequr këtë ligësi nga kjo botë, do të mund të bëhen disa të lumtur. Pra, kur ligësia është e mundshme për t’u kthyer në lumturi, përse njeriu nuk duhet ta bëjë atë? Por çfarë do të mendonte Bentham për një gjë të tillë? Me utilitarizmin e tij ai ka menduar që, sa më pak vuajtje dhe sa më shumë të lumtur. Nuk ka thënë se sa më pak vuajtje, duke vrasur ata që i bëjnë të tjerët të vuajnë. Në asnjë rast ai nuk është shprehur se vuajtja pakësohet duke vrasur të tjerët. Kushdo qofshin ata.

Të gjithë dimë diçka për vrasjet dhe vdekjet e rreth 8 milion njerëzve në dhomat e gazit nga Hitleri. Është fare normale që të gjithë të pyesim se përse njerëzit e asaj kohe nuk e ndjenin për detyrë vrasjen e Hitlerit dhe t’i kursenin njerëzimit kaq shumë vuajtje dhe dhimbje?

Duke e argumentuar rastin sipas teorisë së Bentham, duhet menduar se një tiran që vret dhe mbyllet njerëzit e pafajshëm në dhomat e gazit, që rrezikon paqen në botë, duhet të vritet. Kjo, për arsyen se pesha e fatkeqësisë dhe vuajtjeve që sjell ai tek të

tjerët, janë shumë më të mëdha se sa fatkeqësia e personit që i shkakton ato. Kështu është për kryeterroristin Bin Laden, Sadamin, Milosheviçin, Gadafin etj.

Por, nëse do të mendohej kështu edhe për Thomain, sigurisht që Bentham do të vdiste së qeshuri. Nëse do të pranohej vrasja e Thomait, askush nuk do të ishte në gjendje të thoshte se deri ku do të shkonte vrasja. Kush e di sa politikanë, mashtrues, kriminelë, të sëmurë psikikë, sakatë etj., do të asgjësoheshin brenda natës, në krevat duke fjetur. Imagjinoni panikun që do të shpërthente në gjithë botën! Imagjinoni konfliktet e pafundme që do të sillnin vdekje të tilla! Vuajtjet dhe dhimbjet që do të shkaktonin ato, janë të paimagjinueshme.

Nëse Kristina e mendon rastin me xhaxhain e saj të veçantë, gjithësecili do të kishte të drejtë që rastet e veta t’i mendonte të veçanta. Përse jo!? Kështu që do të kishim një vrasje masive dhe të përherëshme, botërore. Nëse gjithkush do ta gëzonte të drejtën e vrasjes, atëherë askush nuk do të ndjehej më i sigurtë. Nëse Kristina mendon se ka të drejtë ta vrasë xhaxha Thomain, kush mund ta sigurojë ate se dikush tjetër nuk paska të drejtë ta vrasë edhe atë? A mund ta mendojë ajo jetën e saj pa konflikte me të tjerët!?

Vrasja kurrë nuk është, as qetësi dhe as zgjidhje. Ajo është vetëm vuajtje, si në kohën e mendimit dhe pas kryerjes së krimit. Vrasja është ferri i përjetshëm, para dhe pas vdekjes.

Vuajtja, edhe sipas Bentham, nuk pakësohet me vrasjen, qoftë dhe të atij që ta shkakton atë. Vrasja nuk zgjidh konflikte. Përkundrazi, ajo kthehet në reaksion zinxhir konfliktesh.

Morali dhe e drejta nuk janë çështje hamendjesh individësh. Ato janë shumë më tepër. Një të drejtë të përbashkët, askush nuk ka të drejtë ta shpërdorojë, për interesat e veta, sado që të rrezikohen ato. Edhe për rastet ekstreme, shoqëria i ka gjetur dhe përcaktuar të drejtat.

Xhaxha Thomai duhet të vazhdojë të jetojë. Kristina duhet ta zbrazë “shiringën” e helmit.

Lekë IMERAJ
shkrimtar dhe përkthyes

DITA E VERËS NË FSHATIN DUBRAVË TË KAÇANIKUT

- "KTO DIT' VERET JANË KANË SHUMË T'GZUSHME!" -



***Ibush VISHI,**
Dubravë
e Kaçanikut

Jeta, si fenomen, vetvetiu është edhe si një art më vete. Për njeriun, gjithësesi. Por, madje, edhe tek qeniet e udhëhequra thjesht nga instinkti, vërejmë diçka si artistike. Ç't'i themi, p.sh., përsosmërisë së hojeve të bletëve; çerdhes së lejkut; strofullit të dallëndyshes; rrjetës së merimangës; piramidës së milingonave; ose, zërit të bilbilit, të pëllumbit apo zërit melankolik të pupëzës e të tjera! Gjë që, të gjitha këto, në një mënyrë, mbase, mund të inepre-tohen edhe si një formë artistike e manifestimit sado instinktiv, por që materializon vetë ekzistencën, dobinë e këtyre qenieve, ndërkohë që njeriu e përjeton edhe në cilësinë e përmasave dhe kategorive estetike.

Mirëpo, tek njeriu, fenomeni i jetës, veçanërisht manifestohet në mënyrë të vetëdijshme, si praktikë e organizuar për përmirësimin e cilësive të saj materiale e shpirtërore, patjetër edhe me refleksione në ngritje për ndërtimin e infrastrukturës krijuese kulturore.

Po si edhe Dita e Verës, në kuadër të dokeve, riteve e krijimeve të ndryshme shpirtërore-artistike, madje në të gjitha format e shprehjes, përmes: këngës, lojës, veshjes, ushqimit, kënaqësive të ndryshme, frikës, besëtytnive, lutjeve e të tjera ... Me një fjalë, me të gjitha pasuritë e mundshme shpirtërore, të cilat nuk njohin as fundin sasiar, as përsosmërinë ideale cilësore. Megjithëqë arti e ka për synim edhe përsosmërinë...

Dita e Verës, si një nga festat e motmotit, edhe kjo në literaturë njihet të jetë me origjinë pagane. Si e tillë, përkon me stinën e paraverës. Në të vërtetë, në popull, edhe në Dubravën e Kaçanikut, njihet edhe koncepti: "Gjashtë muj' verë e gjashtë muj' dimën!" Prandaj edhe Dita e Verës, pra, në kuptimin themelor të kësaj ndarjeje stinore, në fillim të gjashtëmuajsh të verës.

Kështu, edhe në fshatin tonë, në Dubravë, gjurmimi i mëtejshëm na mësoi se kjo festë mbahej, dhe vazhdon të shënohet, në një nga ditët 14-21 mars, e që këtu në popull thonë: "As ngjashit", as nshatit", përkatësisht ndërmjet javës së gjashtështatë para Shëngjergjit.

Së këndejmi, mendojmë se mu për këtë arsye edhe emërtimi në shumës "Dit' e Verës" ose "Dit' Veret", pra festë që mund të shënohet brenda disa ditësh (të marsit). Kjo festë rëndom njihet si e vajzave. Mirë-

po, së cilës nuk i shmangen as gratë, veçanërisht nusët, por sidomos si ndihmëse gatesash edhe gratë tjera më të vjetra, si baçicat-amviset, që janë edhe të zonjat e bulmetrave e të tjera. Kurse djemtë, më shumë janë si hisetarë në të ngrënë e në të pirë, se sa që ndihmojnë, përveç në sigurinë e druve e ndonjë veprim që u shkon më për natyrë. Pa përjashtuar edhe humorin dhe shakatë, që shpesh bëheshin edhe "pengesë", fillimisht duke ua fikur zjarrin vajzave me borë a me ujë, madje edhe për oxhaku (siç tregon edhe bija Nebije Vishi) ose, pastaj, duke ua "grabitur" ushqimet e të tjera, si duke nxitur edhe "konfliktet e pajtueshme" me motrat e shoqet e tyre.

Rrëfim:



Arife Vishi

Një rrëfim krejtësisht spontan, pas kërkesës, është edhe tregimi i dadës Arife (Arife Vishi):

- "Imi mledh krejt çikat. U mledhshmi me ni shpi t'naj shoqes. I fshishmi mirë edhe shpijën, edhe aborin. Sicilla çojshmi ka dishka për me gatu, për me hangër: dikush tlin, dikush tamël, qetra gjathë, kos, e najnjana e prejke edhe naj pulë. Plakat i marrshmi ma me t'mirë, se ato e kishin bilmetin ndorë. At'her' nuk kish me ble si qetash. Po edhe nusët i marrshmi, se na hala nuk ditshmi bash mirë me gatu, e ato kish qi edhe kishin hi n'magje. Ema edhe ato kishin qef me knu e me lujt me neve, se edhe pi tine kish qi ishin t'reja, ani se u bajshin kishe si pak ma t'nalshme. Po at'her', o vlla, çikat i nalshin edhe pi shkollë e, m'i ik denimit t'hiqmetit, edhe i martojshin

shum' t'reja. Na çikat qi ishmi ma t'vogla, mledhshmi krane për me kall zarmin, për me gatu. Po, për dru, na nimojshin edhe gjemt', pi ktine tonve, qi ishin ma t'vol, ma t'ri. Qitshmi flija, zishmi voe, gatujshtmi amëlzime, ma shum' tatlia, gurabija, e kaniher' edhe havëll. Nejshtmi tu lujt, tu knu e tu kci teri n'aksham. Lujshmi "Topa-hip"², "Topakol"³, "Kile"⁴, "Msheza"⁵, "Qorrasman"⁶, "Guracak"⁷. A naj lojë qetër, qi tibe s'po m'be n'men! Tani, i knojshmi vllazniën, ma s' shumti ata qi kishin m'u martu ma frik. E knojshmi edhe vetin a njana-qetrën:

Lul'e kuqe, lul' bojpepe
Hajde rrina shoqja eme
O ia ove, eve ooo

Shoqe ina sall na dia
Na shkon zani si radia
O ia ove, eve ooo...

Ose, i knojshmi kajk' edhe verës qi ishte t'u ardh':

2) "Topa-hip". Lojë me top të improvizuar leckash. Luhet nga vajzat hipur në shpinë të njëra-tjetres. Organizuar në rreth. Ato e endin topin, e gjuajnë një lojtare që lëviz brenda atij rrethi. E kjo, cilës t'ia grabit topin, e ndërrojnë rolin me të. Kështu, në cikël. Loja ka efekte sportive, argëtuese, por edhe performance sfiduese të shkathësisë kundërshtarë e të bukurisë gjimnastikore.

3) Loja "Topakol" (top në rreth), është e ngjashme me atë "Topa-hip", por më dinamike se ajo, meqë lojtaret të gjitha janë të lira, pa barrën e shoqes në shpinë si te loja "Topa-hip".

4) "Kile". Bartësi i lojës zgjedhet me short. Shorti bie bazuar në numërim, p.sh. një deri në dhjetë, ku dhjeta "banë". Ose, shorti përmes anëve të monedhës - "turrë a jaz?". Si edhe përmes një kënge, ku në përkim fjala ose rrokja e fundit përcakton bartësin e lojës. Të gjithë ikin nga bartësi, ndërkohë që cilindo që të arrijë ta prekë bartësi, ai ose ajo e zëvendëson atë, duke i ndjekur të tjerët. Është lojë dinamike, zhvilluese, që gjithashtu provon shkathësinë.

5) "Msheza". Lojë e njohur. Pas një shorti, njëri i bie t'i mbyllë sytë, deri sa të tjerat të fshihen. Kur këto fshihen, japin shenjë: "U ba!" D.m.th. që symbyllura tani t'i kërkojë shoqet. Posa ta gjejë një, të gjitha vrapojnë të pshtyjnë tek vendi ku ishte symbyllura. Nëse ish-symbyllura arrin ta pështyjë ndonjërin nga to, ose edhe ta prekë, t'ia bëjë "kile" pa arritur tek caku i pështymës, e pështyra duhet t'i mbyllë sytë ("e ban lojën!")...

6) "Qorrasman" (qorr, qorras-mën), luhet po ashtu në rreth, lojtar/-ët, -et dorë për dorë, por që në mes luajnë dy "aktorë": njëri symbyllur me shami, tjetri syhapur që i ik symbyllurit, i cili përpjket ta godasë me një shami të lidhur njëri në fund. Posa të arrijë ta godasë, ndërrohen rolet...

7) "Guracak". Më shumë lojë e vajzave. Luhet me 5 (pesë) guralecë të zgjedhur sa më të rrumbullakët, pak më të vegjël se arrat (sa "arra gungshe"- e vogël e fortë). Luhet ulur, mes dy ose katër (dy nga dy) lojtareve. Kapen të pesë guralecët në një dorë, një hidhet përjetë, katër lëshohen në tokë. Mblidhen nga një ("kanishe"), nga dy ("kadishe")... Më vështirë është "kakat'shja", sidomos kur gurët bien larg e larg, ose "nrrojsat", kur, gjithnjë duke e hedhur një lart, një merret e një lëshohet në vend, për t'u kapur në fund të gjithë guralecët përnjëherë! Ose kur pesë guralecët hidhen përpara duke e kryqëzuar dorën e djathtë me të majtën mbështetur në tokë, si urë - në gishtin e madh e të mesëm. Ku, pastaj, guri rastësor më i largët hidhet përjetë, e të tjerët ndërkohë përbirohen nën atë "urë" "prap e mar", një nga një e më shumë... Më në fund, humbësit i gërrithet e i lëmolet dora në disa mënyra e në disa seanca. Me "sakicë" - "dang!", "teslicë" - "tup!", "turrelë" - "geec!" me "grrithç" - me thjontj - "gëçërrç!" e me "l'mojs"... - me shuplakë a gishta - "fëçësht!"... **Vërejtje:** për çdo "mjet" ndëshkues, numërohet deri në pesë!

Hajdi çika bani mashalla
Po na ven vera lumet na
Hajdi çika për me knue
Qetash lulet kan' me lulue.



Nebije Vishi

Kto Dit' Veret janë kanë shumë t'gzushme. U veshshmi ma mirë, me tesha ma t'reja, po s'ka pas qaq kërkush. Ma shum' tesha t'bezta, dofar' xhaketa, qi naj kepshin nanat. Naj kmish t'pillhurt, po kto ma tepër nusët, se neve na ardhke edhe marre, m'u vesh çikat me t'bardha. I bajshmi edhe dofar' shamija bojkafe, po edhe t'bardha kaniher', ksaj i thojshmi "bashlik". Thojshin, bajat me hec krieshtru't. Po kish qi flokt i majshmi edhe kocel.

Kah akshami e kallshmi edhe ni zarm me gllija. Plakat thojshin me pre dimnin me flakë, me dal n'verë! Flaka e madhe. E, kcejshmi napër flakë... Kaniher' e shtishmi edhe njana-shoqën. Po edhe gjemt na dhashin shtime..."⁸

Siç u tha edhe më lart, Dita e Verës apo "Dit' Veret", në fshatin Dubravë të Kaçanikut festohen edhe tani, por në një koncept më të modifikuar, jo arkaik si më parë, si nga kushtet, edhe nga qasja. Pra, jo me krejt ato ceremoni që ishin, por pjesërisht, ose edhe si një rast për ndeja në shoqëri, e për preokupimet e moshës e të kohës, mirëpo gjithësesi pa e cenuar kohën stinore të kësaj feste.

Vlen të përmendet se tani po shndërron edhe në dukuri festimi i kësaj Dite natën. Kjo edhe për shkak të obligimeve të kohës: shkolla, puna e të tjera. Madje shpesh, mbase edhe si pasojë e organizimit natën, këtë festë këtu djemtë e vajzat e mbajnë edhe ndaras, në shtëpi të ndryshme. Përveç kur organizimi ndodh më në afri familjare. Si ditë e veçantë festive,

8) Arife Nezir Vishi (70 vjeç). Bijë e vejë, pa fëmijë, që tani jeton në gjini. Burrin të vrarë në luftën e fundit në Kosovë.

1) Thotë Nebije Hebibe Vishi (79 vjeç), bijë e fshatit.

LETËR E DREJTORIT TË SHKOLLËS SË MESME “VOLTA”

Nikolin Sh. LËMEZHI

- DREJTUAR NXËNËSVE TË TIJ: “SHPËTONI NGA SËMUNDJA JETËN TUAJ SHOQËRORE!” -

Kjo është letra mjeshtërore që drejtori i shkollës së mesme “Volta” në Milano, Domenico Skuilace u shkroi të gjithë nxënësve të shkollës dhe e publikoi në faqen e internetit të shkollës. Merrni disa minuta për ta lexuar sepse është një kryevepër.

Studentëve aktualë!

“Murtaja, që gjykata shëndetësore kishte frikë se mund të hynte në Milano nëpërmjet bandave alemane, në të vërtetë kishte hyrë tashmë, duke mos u ndalur deri në zhdukjen e gjysmës së popullsisë italiane”.

Fjalët që sapo përmendëm, janë ato që hapin kapitullin 31 të veprës “Të fejuarit”, një kapitull ky, që së bashku me të tjerë i dedikohet tërësisht epidemisë së murtajes që goditi Milanon në vitin 1630. Bëhet fjalë për një tekst që të hap sytë, me modernizëm të jashtëzakonshëm që ju këshilloj ta lexoni me vëmendje, sidomos në këto ditë kaq të pështjelluara.

Brenda atyre faqeve ekziston tashmë gjithçka, kanosja e rrezikut nga të huajt, përplasja e dhunshme mes autoriteteve,

kërkimi spazmatik për të ashtuquajturin pacientin zero, përbuzja për ekspertët, gjuetia për ata që përhapën sëmundjen, zërat e pakontrolluar, mjetet më absurde, bastisja për nevojat themelore, urgjenca shëndetësore e të tjera si këto...

Në ato faqe do të hasni, ndër të tjera, emra që, me siguri i njihni duke frekuentuar rrugët përreth shkollës sonë të mesme që, le të mos harrojmë, qëndrojnë aty ku ka qenë spitali për sëmundjet infektive i Milanos; emra si Ludovik Setala, Aleksandër Tadino, Felice Kasati e të tjerë. E thënë me fjalë të tjera, më shumë se nga romani i Manzoni, ato fjalë duket se kanë dalë nga faqet e një gazete të ditëve të sotme.

Të dashur fëmijë! Nuk kam asgjë të re në këtë botë që mund të them, megjithatë shkolla e mbyllur kërkon që unë të flas. Shkolla jonë është një nga ato institucione që me ritmet dhe ritualet e saj shënon kalimin e kohës dhe shpalesjen e rregullt të jetës civile, jo rastësisht mbyllja me forcë e shkollave është diçka që autoritetet e përdorin në raste të rralla dhe

me të vërtetë të jashtëzakonshme. Nuk më takon mua të vlerësoj përshtatshmërinë e masës, nuk jam ekspert dhe as nuk pretendoj të jem, i respektoj dhe i besoj autoritetet dhe respektoj deri në përpikëri drejtimit që na kanë dhënë. Ajo që dua t’ju them është që të jeni gjakftohtë e të mos lejoni që të tërhiqeni nga mashtrimi kolektiv, që ju privon për të vazhduar - me masat e duhura paraprahe - për të bërë një jetë normale. Përfitoni nga këto ditë për të bërë shëtitje apo të lexoni ndonjë libër të mirë.

Nuk ka asnjë arsye - nëse jeni mirë - të qëndroni të mbyllur në shtëpi. Nuk ka asnjë arsye të mos shkoni në supermarkete dhe farmaci: maskat u jepen atyre që janë të sëmurë dhe janë vetëm për ta. Shpejtësia me të cilën mund të lëvizë një sëmundje nga një skaj i botës në një tjetër është bijë e kohës sonë dhe nuk ka asnjë mur që mund ta ndalojë. Shekuj më parë këto sëmundje lëviznin në të njëjtën mënyrë, veçse me ritme më të ngadalta. Një nga rreziqet më të mëdha në ngjarje të tilla, ku na e mësoi Manzoni dhe mbase

edhe më shumë Bokaçio, është helmimi i jetës shoqërore, marrëdhëniet njerëzore, dhe barbarizimi i jetës civile.

“Instinkti atavistik” (i paraardhësve) kur ndiheni të kërcënuar nga një armik i padukshëm, është ta shihni rrezikun kudo, duke bërë që ta shikojmë secilin nga shokët tanë si një kërcënim dhe si një agresor të mundshëm. Në krahasim me epidemitë e shekujve të katërmëdhjetë dhe shtatëmbëdhjetë kemi në anën tonë ilaçet moderne dhe, më besoni, kur them se kjo nuk është pak, duke përmendur përparimin dhe siguritë e këtyre ilaçeve. Le të përdorim mendimin racional që është thelbi për të ruajtur pasurinë më të çmuar që zotërojmë: strukturën shoqërore dhe njerëzimin tonë. Nëse nuk arrijmë ta bëjmë këtë, atëherë murtaja do të ketë fituar me të vërtetë.

Ju pres së shpejti në shkollë,

Domeniko Skuilace,

26 Shkurt 2020

Përktheu:

Nikolin Sh. LËMEZHI

karakterizohet nga eleganca, në përzgjedhjen e ushqimeve, rrobave, shoqërisë, veglave dhe enëve, ushtrimit të pastërtisë, qëndrimin dinjitoz e gazmor, mikpritjes dhe bujarisë, vargjeve e lojërave të zgjedhura sa më artistike e më figurative. Të gjitha këto, me një synim që mundësisht krejt kjo atmosferë të jetë sinonim i vërtetë i së mirës, të bukurës, të dobishmës e i një sjelljeje dhe manifestimi kënaqësie në kapërcyell të stinës kah e ngrohta pranverore.

Një ilustrim atmosfere të kësaj feste na paraqitet edhe në këngën në vazhdim:

*Ja paska nis çika me çit' fli
Ani ren për ren e ka përhi
Kush ta ha moj shoqe ti ket fli
Ani shoqe mos bahi marak
Na e hana fliën tu ba llaf*

*P'e qitka çika fliën rena-rena
Qish i qitka petillat si dega me rrema
Ani mori çik'o moj lul'kane
Na qet fli ja çojna vehrës tane*

*Çikat e mahallës janë tubu te shpia
Për ditë vere qesin gurabia
I shpojkan me krane si shosha me bira
I pekkan me saç-o u dokkan si lira*

*Kimi mledh harxh e kimi gatue
Na ka shkue dita tu kesh e tu knu
I kimi hangër ka pak e ka pak*



*Gjemt' e mahallës s'na kan' lan' rahat*⁹

Literatura - informatorët:

- Intervista me bija – vajza dhe gra të fshatit Dubravë.
- Demush Shala: “Letërsia Popullore”, Enti i Teksteve dhe

⁹ Fetije Malsiu-Berisha (rreth 70 vjeç), lindur dhe martuar në Dubravë.

Vajza duke luajtur lojën me guraleca

- i Mjeteve Mësimore i KSAK, Prishtinë, 1983.
- Demush Shala & Abdullah Zajmi: “Leximi letrar”, ETMM i KSAK, Prishtinë, 1972
- Alfred Uçi: “Probleme të estetikës”, RB Rilindja, Prishtinë, 1980.
- Zymer Ujkan Neziri: “Poetika e

krahasimit”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2004.

*Drejtori i shkollës së mesme profesionale “Skënderbeu”, në Kaçanik. Punuar: mars 2016

*** POEZI *** ** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI ***

MOS TË LOSIM ME VLERAT TONA

Para një viti, muaj t'prillit
Nji artikull me vlerë, problem shqetësimit
Ai problem të gjithëve na prekë
Megjithëse jetoj në kurbet
Edhe mua në shpirt më godet
Fakte të kohës t'jetës reale
Me rëndësi të vlerave morale
Analizë e profesorit t'nderue
Në çdo kohë vlerat me shkruen
Për Dukagjinin e madhëruem
Shoqata Atdhetare "Dukagjini"
Thirrje burrërore, ajo na bani
Me rrejt vlerat, që ka vatani
Besë, nderë e trimëri
N'ar na lanë të parët dhunti
Me vlerat tona, mos t'bahet tregti
Ka ardhë koha e arsytimit
Për kohën reale të zhvillimit
Na vinë ngjarjet si n'befasi
Vinë si vinë, do si "Zotëri"
Me premtime plot djallëzi
Na shfrytëzojnë besë e burrëri
Nisin punën me bujë t'madhe
Bllokojnë fusha e livadhe
Tokë buke, bregore e male
Thonë leverdia asht me pare
Gjithë prodhimin e shfrytëzojnë
Edhe djersën e mundin tonë
Në vend të prodhimit e bujarisë
Mbjellin farën e poshtërsisë
Ato bimë të lindur prej djallit
Me të lodhë nderin për së gjallit
Ata "Zotëri" veshë me "autoritet"
Na paraqiten si me respekt
Me emra falloco pa identitet
Ndoshta veshë edhe me "pushtet"
Për interesat e xhepit t'vet
Vinë e shkojnë porsë era
Fluturojnë vlerat në qytete tjera
E s'mundesh me i dal zot vetit
Se t'xen pika e sherrit
Se nuk na i njohin vlerat e nderit
Na marrin fitesën e volumit
Na shpërblejnë me vlerën e turpit
Në sofër të parë në dhomat burgut
Rrofshin premtimet e fjalët e mëdha
Në vatan e keqja ka ra
Hymë në ngatresë vllau me vlla
Me njëri-tjetrin shkak me u vra
Ju o vllazër t'Dukagjinit burrërisë
Besa asht simboli i lavdisë
Jemi në shekullin e djallëzisë
Mos lozni me vlerat tona
I rejtën shekujt deri në ditët e vona
Jemi Dukagjini kështjella e trimërisë
Na dhuruan burrat e lavdisë
Ato t'i rrejme e nderojmë
Me vlerat tona mos t'na mashtroni
Ndodh mirbesimit t'i shihet sherrit
Dashtë pa dashtë të damtohet nderi
Nji burrë i urtë dikur motit
Marash Uci trim prej Hotit
Amanet ai na pat lanë
Me mençuri pat thanë:
"Të huejin me fjalë mos e poshtëroni
Bukën përpara, por t'ia shtroni
N' Shqiptari si e ka zakoni
Me i besue mos i besoni"
Kështu i porositi djemt' e Hotit
T'i analizojmë djallëzit e sodit

Jem simboli i besnikërisë
Të ruhemi rasteve të paburrërisë
E pasojave të padrejtësisë
Kemi nderë e autoritet
Kem ba luftë me qindra vjet
Nuk na mposhti lufta as agresori
Pse hashashi vlerat na i lodhi
Jemi trima zemër bujarë
Gjithmonë të parë fitimtarë
Trima të fort me nder e besë
Për trojet tona dolëm me vdekë
Lanë të parët amanet
Kem kurajo aftësi morale
T'i rrejme vlerat e qindresës madhe
S'pranojmë llafe, as vlera monetare
Janë të shenjta besa e trimëria
Me ato s'ka vlerë tregtia
Se me gjak i rrejti malësia
Malësia trime e Dukagjinit
E ka emrin n'flamur t'përjetësimit
Ju o vllazën, burra t'Dukagjinit
Burra trima të besës e qytetimit
E intelektualët e nderimit
Diplomue n'Shqipëri e shtete t'Prendimit
Ju rinia me edukatë evropjane
T'i rrejme vlerat e kësaj nane
Dhe emigracioni n'dhenat t'huej
Mos harroni Dukagjinin tuej.
Vlerat e të gjithëve e ndihma e Zotit
Për Dukagjinin "Nderi i Kombit".

Pjetër GERAJ
Belgjikë, shkurt 2020

FALEMINDERIT, O ZOT, PËR COVID-19!

"Le të rrijë vetëm e të qëndrojë në heshtje kur Zoti ta mbrehë në zgjedhë!" (Vajtimet 3, 28).

Jam ulur këtu në heshtje, o Zot i jetës,
dhe mendoj për atë çfarë po ndodh.
Libri i Shenjtë i Biblës thotë:
"... Ti i kursen të gjitha, sepse janë të tuat,
o Zot jetëdashës...". (Urtia 11, 26)
Zemra ime është e përmbetur me paqe,
por si në një film shoh viktimat
e këtij virusi të ri, familje që qajnë,
prindër, vëllezër e motra nëpër spitale,
bij e bija plot me frikë.
Përpara syve të mi lajme, statistika,
këshilla për një kujdes më të madh,
që në të shumtën e rasteve ngjallin ankthe e shqetësime.
Ndoshta edhe lutje, lutje për mbrojtje dhe për shërim,
por pak ose aspak falënderime.
Jam ulur këtu në heshtje, o Zot jetëdashës,
dhe ndërsa lutem e meditoj,
në praninë Tënde gjithçka merr kuptim e dritë.
Më kujtohet historia e Lazrit, mikut Tënd, o Jezus,
kur Ty të lajmëruan se ai ishte i sëmurë, e Ti the:
"Kjo sëmundje nuk është për vdekje,
por për lavdi të Hyjit,
që të nderohet në saje të saj i Biri i Hyjit".
(Gjoni 11, 4)

Jam ulur këtu në heshtje e në paqe, o Zot,
dhe të falënderoj për këtë sëmundje të re,
e cila sigurisht është për lavdinë Tënde.
Në misterin Tënd të pashqyrteshëm,
unë e di mirë se gjithë kjo që po ndodh
është për shpëtimin tonë,

për paqen e atyre që janë afër e të atyre që janë larg.
Para syve të mi shpalosen vuajtjet
dhe grahamat e atyre që do paraqiten tek Ti,
dhe me psherëtimën time të thellë i kujtoj
para Teje, o Atë, një e nga një,
ata që ikën dhe ata që po vijnë:
Pranoji në përfaqimin Tënd të përjetshëm!

Të falënderoj me gjithë zemër, o Zot i çdo mëshire,
për gjithçka që ke lejuar në jetën tonë,
të falënderoj për çdo vullnet Tëndin,

të falënderoj për çdo bekim dhe hir,
që Ti na ke sjellë dhe do të na sjellësh përsëri,
nëpërmjet COVID-19.
Në duart e Tua ne jemi,
gjithçka prej Teje pranojmë me dashuri e me paqe:
Prandaj, Ty, të qofshim falë!
Dhe çkado që në këtë jetë
e pas kësaj jete të na ndodhë,
o Jezus të na mbash në hirin Tënd gjithmonë
ne përvujtërisht të kërkojmë!

5 personazhet më krijues gjatë periudhave të karantinës në botë



Shumë persona u bënë të famshëm nga shpikjet e tyre gjatë periudhës së karantinës.
Sipas Mental Floss, më poshtë janë 5 personat që prodhuan vepra botërore gjatë karantinimit.

William Shakespeare: Ai ishte një aktor dhe aksionar me një trupë teatrore të The King's Men kur murtaja bubonike detyroi teatrot e Londrës të mbyllen në fillim të shekullit të 17-të. Kompozoi mbretin Lir, Macbeth dhe Antony e Cleopatra përpara se të mbaronte viti.

Isack Njuton: Në vitin 1665, kur Njutoni ishte në fillim të viteve 20, një nga shpërthimet e fundit të mëdha të murtajës bubonike goditi vendin. Matematikani i ri prodhoi disa nga punët e tij më të mira gjatë vitit të tij në karantinë, duke përfshirë teorinë e tij të gravitetit.

Edvard Munch: Autori i pikturës së famshme "Scream", Edvard Munch jo vetëm që ishte dëshmitar në pandeminë e gripit spanjoll në botë përreth tij, por ai e kontrakttoi sëmundjen rreth fillimit të vitit 1919, ndërsa jetonte në Norvegji.

Thomas Nashe: Ishte një dramaturg Elizabetian që fitoi famë në të njëjtën kohë me William Shakespeare.

Giovanni Boccaccio: Ishte prekur nga murtaja bubonike dhe i mbijetoi shpërthimit duke ikur nga qyteti dhe duke u fshehur në fshatin toskan, ku shkroi "Decameroni".

REDAKSIA

Mundësuan Botimin: AVOKATËT DONIKA E AGIM MARTINI



REDAKSIA

Kryeredaktore: Suela Ndoja
Redaktorë: Luigj Shyti, Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Kole Çardaku, Eilda Delija, Age Martini, Klodiana Serraj, Vilson Peshkaj, Marijan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza e Ndue Ziçi.